


# VEND / KULTURE / IDENTITETE

nga brigjet e Vjoses ne internet

duke luajtur me muziken dhe fjalet  
libri per arsimtarin







Vend / Kulture / Identitete  
Nga brigjet e Vjoses ne internet

Duke luajtur me muzikën dhe fjalët  
Libri per arsimtarin

Uneversiteti i Janinës  
2008



Vepra u realizua ne kuadrin e Programit INTERREG III / PROGRAMI I FQINJESISE GREQI – SHQIPERI  
Boshti 2-Metri 2.2. me bashkefinancim nga Fondi Evropian i Zhvillimit Periferik (F.E.ZH.P.) dhe nga Burime Kombetare.  
Pergjegjes Shkencor: Anastasios Emvalotis, Profesor Asistent i Universitetit te Janines

Vend / Kulture / Identitete  
Nga brigjet e Vjoses ne internet

Duke luajtur me muzikën dhe fjalët  
Libri per arsimtarin

ISBN: 978-960-233-192-7

copyright © Uneversiteti i Janinës, 2008

Pjesmarrës botimi

***Përgjegjes shkencor i veprës***

Anastasios Emvalotis, Profesor Asistent  
i Universitetit te Janines

***Koordinues i veprimeve të veprës***

Dimitris Paraskevakis

***Pergjegjes shkencor i grumbullimit  
i materialit kerkues***

Vasilis Niciakos, Profesor i Universitetit te Janinës

***Grupi Kerkues***

Kostas Manxhos, Vasilis Raptis, Kostas Lolis,  
Niko Michail, Thomas Porikis

***Inçizim***

Nikos Dhionisopoulos

***Përgjegjes shkencor i zhvillimit  
të materialit edukativ***

Jeorgjios Kapsalis, Profesor në Universitetin e Janinës

***Vlerësimi ë skenarëve edukativë***

Athanasios Verdis, Lektor në Universitetin e Athinës

***Grup i zhvillimit të skenarëve edukativë***

Vasiliki Basina, Vasiliki Leondari,  
Harilaos Nucos, Athanasios Verdis,  
Tatiani Derdemezis, Fotini Mballomenu

***Përkujdesja e materialit pamor dëgjimor***

Tatiani Derdemeyis

***Përkujdesja e skenarëve edukativë në greqisht***

Fotini Mballomenu

***Përkujdesje e skenarëve edukativë në shqip***

Maria Sidheri-Skopi

***Digjitalizim i materialit***

Argjiris Janelos

***Planifikimi dhe përkujdesje grafike e botimit***

Jeorgjia Koloka



## Pasqyara e lëndës

---

Paralhënie .....	5
Konica dhe Përmeti, vendi dhe njerëzit. ....	11
Metodologjia.....	13
Gjeografia kulturore.....	17
Konica	17
Përmet	25
Kufiri dhe ëmigracioni.....	35
Arti i tingullit .....	47
Niveli 1	49
Niveli 2	50
Niveli 3	50
Cikli i jetës .....	51
Niveli 1	53
Niveli 2	54
Niveli 3	55
Kafshët dhe natyra .....	56
Niveli 1	58
Niveli 2	60
Niveli 3	61



# Pasqyara e lëndës

---

Uji na fletë..... 65

Niveli 1 66

Niveli 2 66

Niveli 3 66

Profesionet tradicionale..... 69

Niveli 1 71

Niveli 2 72

Niveli 3 73

Mërgimi..... 77

Niveli 1 78

Niveli 2 79

Niveli 3 81



## Vend – Kulture – Identitete

---

### Nga brigjet e Vjoses ne internet

Vepra synon ne bashkepunimin kerkues Greqi – Shqiperi me qellim paraqitjen e elementeve te perbashketa kulturore ne zonen nderkufitare si dhe vleresimin pedagogjik e didaktik me ndihmen e Teknologjive te Informacionit dhe te Komunikimeve. Vecanerisht, brenda nga fusha e kerkimit sistematik shkencor u bene regjistrime ne zonen e aplikimit te programit. Vendi ku u zgjodh per grumbullimin e materialit empirik, qe ishin krahinat e Konices ne Greqi, dhe e Permetit ne Shqiperi, mund te perfytyrohet brenda nga takimi i dy kufijve. Njeri, kufiri politik rezultat i zhvillimeve historike, dhe tjetri, lumi Vjosa, qe duke u nisur nga malet e Pindit pershkron ne menyre te njepasnjeshme fushen e Konices dhe luginen e Permetit, duke krijuar nje «tjeter» lidhje territori, qe cojne ne kohe te ndryshme nga ato te kufirit politik. Historiku i kufirit (politik) dhe historiku i lumit cojne ne historikun e grupeve shoqerore qe jetojne ne brigjet e tij. Duke u bazuar ne kete historik ose ne historike, nderhyrja kerkimore perpiqet te paraqese te dhena te zonave ne Greqi dhe ne Shqiperi qe bashkohen dhe ndahen njekohesisht nga kufiri dhe lumi dhe t'i vleresoje didaktikisht ne Arsimin e Shalles se Pare. Veprimet e vepres perfshijne kerkimin bibliografik, grumbullim ne vend, krahasimin dhe vleresimin e materialit kerkues me emfaze ne traditen muzikore popullore dhe zhvillimin e skenareve edukative per Arsimin e Shkalles se Pare. Vecanerisht:

### 1. KERKIM – GRUMBULLIM – KONFIRMIM

*Kerkim na vend dhe grumbullim i materialit origjinal.*

Kerkimi (ne vend) dhe grumbullimi i materialit muzikor ishte nje nga pikat me kritike ne realizimin e programit kerkues. Shkencetare te cpesializuar ne degen e tyre (antropologe shoqerore, muzikologe, shkencetare qe merren me studimin dhe kerkimin e te dhenave kulturore etj) bashkepunuan, qe te perfundoje brenda afatit dhe me menyre ta sakte shkencore grumbullimi i materialit. U morren parasysh modele nderkombetare dhe “praktika te mira” te afirmuara. Regjistrimet u bene ne terren dhe ne kuadrin shoqerore te







traditave te gjalla te grupeve konkrete qe u perkasin valleve instrumentale te ekzekutuara nga kompani muzikore dhe kengeve origjinale fonetike popullore qe u kenduan nga njerez te thjeshte-banore te zonave. Duhet permendur se ne kete zone gjeografike gjenden shume tradita te pasura muzikore, por dhe varinate te shumta te kengeve popullore (monofonia, difonia, polifonia). Kerkimi dhe regjistrimi lejoi krahasimin dhe paraqitjen e ngjashmerive dhe ndryshimeve. U krijua keshtu nje harte etnologjike dhe kulturore e zones se gjere qe ndan kufijte kombetare .

*Konfirmimin i materialit.*

Materiali u perkthye (nga shqip ne greqisht dhe anasjelltas) dhe u konfirmua qe te jete i mundur vleresimi i tij nga arsimtaret dhe kerkuesit ne Greqi dhe ne Shqiperi.

## 2. PRODHIMI I MATERIALIT EDUKATIV MULTIMEDIA DHE ZHVILLIMI I ZBATIMIT NE INTERNET TE EDUKIMIT NGA LARGESIA

Ne kuadrin e kesaj veprimtarie u krijuan:

**(a)** Dy CD me kenge origjinale tradicionale te incizuara te zones se zbatimit te planit.

**(b)** Nje zbatim multimedia i disponueshem ne forme DVD me shembuj skenaresh edukativ. Materiali edukativ qe u prodhua lejon vleresimin autonom te produktit kulturor ne klasat e arsimit te shkalles se pare, si ne palen greke, ashtu dhe ne palen shqiptare. Me ndihmen e zbatimit multimedia nxenesit ne kuadrin e skenareve edukative te propozuar vijne ne kontakt me tingujt dhe muziken popullore. Ne kuadrin e afrimeve ndertematike vleresojne regjistrimet dhe traditat, te cilat u perkasin valleve instrumentale dhe kengeve popullore fonetike.

**(c)** Zbatim ne internet i edukimit nga largesia me shembuj skenaresh edukative dhe me afrim pedagogjik te perfunduar. Zbatimi qe u planifikua dhe u zhvillua ne moodle (<http://moodle.com>) lejon hyrjen, gjetjen tematike, perdorimin dhe paraqitjen ne internet te nje



ser skenaresh edukative. Perbehet nga faqe interneti (web pages) dhe nga numerues faqesh(web browser). Platforma elektronike mbeshtetet kryesisht ne nje nensistem qe vendos permbajtjen e adreses elektronike ne internet ku publiku mund te hyje (nensistem paraqitjeje), kurse me ndihmen e nensistemit shoqerues perdorues te autorizuar (arsimtare ose kerkues), regjistrojne, aktualizojne dhe vleresojne materialin edukativ, krijojne grupime ose administrojne informacionin multimation (nensistem perdorimi).

Se fundi **(d)**, jashte detyrimeve konvencionale u hartua dhe u zhvillua vend interneti ne dy gjuhe —greqisht dhe shqip (<http://interreg.edu.uoi.gr>).



## Grupi i punës përbëhet

---

Anastasios Emvalotis, Nd. Profesor i Universitetit te Janines

***Pergjegjes Shkencor i Grumbullimit i Materialit Kerkues***

Vasilis Niciakos, Profesor i Universitetit te Janines

***Grupi Kerkues***

Kostas Manxhos, Vasilis Raptis, Kostas Lolis, Niko Michail, Thomas Porikis

***Inçizim***

Nikos Dhionisopoulos

***Pergjegjes shkencor i zhvillimit te materialit edukativ***

Jeorgjios Kapsalis, Profesor i Universitetit te Janines

***Grup i zhvillimit te skenareve edukative***

Vasiliki Basina, Vasiliki Leondari, Harilaos Nucos, Athanasios Verdis,  
Tatiani Derdemezis, Fotini Mballomenu

***Zbatim pilotik dhe vlerësimi***

Anastasios Emvalotis, Athanasios Verdis

***Perkthim nga greqisht ne shqip:***

Maria Sidheri-Skopi

***Perkthim nga shqip ne greqisht:***

Kostas Lolis

***Grupi i administrimit te ndjekjes se programit:***

Dhimitris Paraskevakis, Ekaterini Dalabira

***Grupi i mbeshtetjes teknike***

Jeorgjia Koloka, Dhimitris Vangjelis, Argiris Janelos



Vend / Kulture / Identitete: nga brigjet e Vjoses ne internet  
Duke luajtur me muzikën dhe fjalët





## Konica dhe Përmeti, vendi dhe njerëzit

---

tekst për programin e regjistrimit të muzikës  
dhe prodhimit të materialit në kuadër  
të programit Interreg Greqi – Shqipëri

Vendi që u zgjodh për grumbullimin e materialit empirik (pamor – dëgjimor) të programit kërkues, krahinat e Konicës në Greqi dhe të Përmetit në Shqipëri mund të përfytyrohet përmes dy termave. Njëri, kufiri politik i zhvillimeve historike, ku në fund të shekullit të 19të dhe në fillim të shekullit të 20të, diktuan përfundimisht ndarjen e rajonit në dy shtete të ndryshme dhe tjetri, lumi Vjosa duke filluar nga shpatet malore të Pindit përshkon njërin pas tjetrës fushën e Konicës dhe luginën e Përmetit duke formuar një unitet «tjetër» vendi që na çon në periudha kohore të ndryshme nga ato të kufirit politik.

Këtu duam t'i shmangemi përfytyrimit formatik të dy termave, njërit të shkaktuar nga njeriu, konkretisht të kufirit politik –përballë një gjëje natyrore dhe jo historike dhe tjetrit– një lumi, një ndarje politike përballë një uniteti gjeografik. Duke pasur parasysh se «natyrorja» dhe «njerëzorja simbolikja» dhe «realja» përbëjnë kategori shoqërore d. m. th produkte të marrëdhënieve të shoqërive konkrete me mjedisin, duam të mbështesim dallimin por edhe përputhjen e të dy termave, në kushte analitike të ndryshme të historisë.

Historiku i kufirit politik që ndonjëherë në sytë e njerëzve ngjan si një madhësi fizike absolute dhe historiku i rrjedhjes së lumit që janë të natyrshme historiku i grupeve shoqërore që jetojnë krah tij. Me bazë këtë histori ose historitë ky tekst përpiqet të skicojë karakteristikat e zonave të ndryshme në Greqi dhe në Shqipëri që bashkohen dhe ndahen njëkohësisht nga kufiri dhe nga lumi.



Në tekstin që vijon fillimisht analizojmë parimet metodologjike bazë që të bëhen të qarta termat me të cilat u bë grumbullimi i materialit konkret pamorodëgjimor. Vijnë një përshkrim nga këndvështrimi i gjeografisë kulturore të zonave që studiohen, si edhe një histori e shkurtër politike e krijimit dhe të karakterit të transformuar të kufirit. Në fund e mbyllim me një referim sinoptik në ndryshimet që solli, në rajon gjatë dy dekadave të fundit emigrimi masiv nga Shqipëria për në Greqi si referencë bazë për mirëkuptimin e kuadrit të prodhimit dhe riprodhimit të materialit empirik që keni në duart tuaja.



## Metodologjia

---

Sipas rregullit trajtimi filologjik i këngës popullore si «lapidar i fjalës» që dominoi akoma dhe në folklor nuk la hapësira të mëdha për kërkime që do të nxirrnin në dukje përmasat e tija teleturgjike.

Nxitja e studimit në drejtim të afrimit drejt një folklori shoqëror edhe problemi u hartua mjaft mirë problemi i funksionimit shoqëror të këngës duke e inkuadruar në kuadrin e traditës, nuk kishte premisat jo dhe aq ato teorike se sa teknologjike për përdorimin e një metode që do të favorizonte shprehjen «gjatë të kënduarit» me fjalë të tjera sipas zakonit të përcaktuar në kryerjen e procesit gjatë të cilit kënga paraqitet jo vetëm thjesht si tekst dhe melodi por si një shërbim i kompletuar tek i cili rëndësi të madhe ka realizimi i pjesës së dramatizuar. Është e dukshme se një vështrim të tillë përballon kënga popullore si interpretim gjë që tregon se regjistrimi dhe studimi i saj kërkon metoda dhe teknika analoge.

Është e njohur tek ata që morën pjesë në shfaqje të gjalla shoqërore, në të cilat kënga ka rol liturgjik, se sipas kuadrit zakonor dhe llojit të shfaqjes ekzistojnë ligje të pashkruara konkrete dhe mënyra shprehjeje që përcaktojnë faktin e të kënduarit. Kjo nuk ndodh vetëm në zakonet me përmasë teleturgjike (ceremonitë e dasmave, vajet etj.) por dhe në situatë të përditshme në të cilat kënga luan ndonjë rol si p.sh. në festat shtëpiake në të cilat mbizotëron kënga e tavolinës. Kuadri nuk përcakton vetëm brendinë e këngëve, përcakton dhe realizimin prandaj dhe vetë këngën e takojmë në të njëjtën bashkësi në më shumë se një ndryshim muzikor. Mundet për fenomenin shumëliturgjik të këngëve, ku nga pamja më e gjerë. Folklorike dhe muzikologjike kërkon një klasifikim shoqëror dhe zakonor për realizimin e një studimi dhe regjistrimi të saktë. E njëjta pjesë p.sh. mund të këndohet me ritëm kërcimor, me ritëm pune si këngë prashitjeje ose akoma me ritëm të ndenjtur si këngë tavoline.



Nga vërejtjet e mësipërme hyrëse del përfundimi se po të supozojmë se kënga popullore është një fakt teleturgjik i klasifikuar në një kuadër shoqëror konkret, atëherë duhet të mbështesim se regjistrimi i saj dhe të kënduarit ose paraqitja e saj duhet bërë brenda këtij kuadri. Dinka e tillë supozon sigurisht dhe përdorimin e mjeteve teknike që kanë mundësi regjistrimi jo vetëm të tingullit por dhe të figures, dhe akoma të figures lëvizëse. Kjo sigurisht dëgjohet si dinka e zakonshme ndoshta, por nuk është fare, pot ë mendohemi se akoma dhe sot kënga popullore paraqitet sipas rregullit në përmbledhje të ndryshme sidomos si tekst.

Është e dukshme se një shikim i tillë trajton këngën popullore si interpretim, gjë që tregon se regjistrimi dhe studimi i tij kërkon metoda dhe teknika analoge tek të cilat dikush mund të dëgjojë edhe «të kënduarit» dhe të ketë një kohësisht shumë fakte për kuadrin historik dhe shoqëror akoma edhe fotografi që tregojnë vendin, ceremonitë etj. dhe kjo mënyrë nuk është e mjaftueshme nëse pranojnë konstatimin tonë fillëstar. Nuk është e mjaftueshme nëqoftë se jo vetëm se fotografia është statike por sepse kryesisht ky fakt jepet i shkëputur: muzika, teksti, figurat, komentet etj.

Xhirimi kinematografik ose në video është një tematik që i tejkalon këto pengesa, por dhe këto të vecuara nuk janë të mjaftueshme për një përdorim më të gjerë shkencor. Disponojmë gjithashtu sot në sektorin e informatikës mjete shumë funksionale (multimedia) me të cilat mundet dikush të japë njëkohësisht zë, figurë dhe tekst duke mbuluar sa nevojat e rendimentit të gjallë të vendit natyror të kuadrit shoqëror të ceremonisë zakonore, të vetë të kënduarit sa dhe nevojën e vërtetimit shkencor.

Duke kaluar tani nga kuadri metodologjik tek i cili u mbështet përmbledhja materialit empirik në procesin kërkues konkret, gjykojmë të domosdoshme të trajtojmë çështje konkrete që na dolën gjatë procesit kërkimor. Që në fillim duhet të theksojmë se të gjitha regjistrimet u organizuan nga kërkuesit. Kjo u bë përmes takimeve të planifikuara me grupe njerëzish në vende publike (kafene) dhe private (shtëpi). Fjala se përse nuk kishim regjistrime gjatë kohës së përgatitjes ishte faktori kohë. Që të mundet dikush të regjistrojë funksionimin e muzikës brenda një kuadri të caktuar kërkimi është i domosdoshëm se duhet të identifikojë kohën e kërkimit me kohën shoqërore gjatë kërkimit nëpër fshatra, gjë që në rastin konkret nuk ishte e mundur.



Ky fenomen shënon një përfytyrim ndërmjetues për nevojat kërkimore të procesit, realisht në rastet më të shumta në terren u krijua një kuadër ad hoc zbatimi ku duke fituar një dinamikë të vecantë, solli në dukje jo vetëm pamje të kulturës vendore por dhe të marrëdhënieve shoqërore midis pjesëmarrësve. Në këtë ndihmoi përpjekja e vazhdueshme e mos ndërhyrjes nga ana e studiuesve, duke u dhënë mundësi atyre që na jepnin informata që të zgjidhnin vetë llojin dhe radhën e këngëve, të shprehnin vetë hierarkinë e brendshme të grupeve brenda nga zgjedhjet e tyre (kush këndon, cilën këngë), si dhe nivelin teknologjik të mjeteve të regjistrimit që lejonte të nënvleftësohej ndjenja e vetë regjistrimit të asaj që ndodhte.

Regjistrimi në Shqipëri u bë gjatë kohës së dy vizitave pesëditore. Qëllimi ishte që të mbulohej gjeografikisht gjithë zona që nga kufiri politik deri në Përmet duke përfshirë fshatrat në të dyja anët e lumit, ndërsa paralelisht të grumbulloheshin këngë nga të gjitha grupet etnike të zonës. Kështu kemi regjistrime nga fshatrat Kosinë, Kutali, Benjë, Petran të qytetit të Përmetit, Kilarist, Vllahopsilloterë, Leshicë, Zhepë, Leskovik dhe Carshovë.

Shumica e këngëve të regjistruara janë në gjuhën shqipe, por ka dhe këngë në gjuhën vllehe (nga fshtrat Kosinë, Kutal dhe Leshicë) ku ka popullsi vllehe dhe në greqisht (të gjitha regjistrimet në fshatin Vllahopsillotierë dhe një numër i vogël i atyre që u regjistruan në fshatin Carshovë), ndërsa ekziston dhe një numër i vogël por i rëndësishëm i këngëve dy gjuhëse (ose shqip dhe vllehce ose shqip dhe greqisht).

Përvec faktit se pjesa më e madhe e materialit empirik i kushtohet formave fonetike, u synua dhe përfaqësimi i veglave tradicionalë muzikore të zonës, që është gjithashtu një pjesë e rëndësishme e kulturës muzikore të vendit. Kështu u bënë regjistrime nga grupe muzikore në Përmet dhe Leskovik, vende tek të cilat është bërë e ndjeshme ndërgjegja e ndryshimit të muzikës ekzistuese vendore, ndërgjegje që u përforcua dhe përforcohet nga pjesëmarrja apo përdorimi (sipas shikimit) të kësaj ekzistence gjatë formimit (gjatë shekullit të 20të), të rijë «etnikisht» traditë muzikore.







# Gjeografia kulturore<sup>1</sup>

---

## rajonet e Konicës dhe Përmetit

**KONICA** Gjeografia fizike e zonës më të gjerë të Konicës, është një udhëzues i mirë për t'u kuptuar strukturimi shoqëror, kulturor dhe prodhues i vendit gjatë viteve. Kjo nuk do të thotë se ambientalizmi është faktori përcaktues, por patjetër kjo përbën një kuadër që dikton me mënyrën e vetë të përdorimit dhe funksionon deri në një farë shkalle si kufizues. Ekzistojnë realisht një korrespondencë karakteristike midis zonave mjedisore dhe grupimeve kulturore që përbëjnë nga ndryshimet e tyre identitetin e zonës.

Zona e Sarandaporit që shtrihet nga kufijtë e Maqedonisë Përendimore deri në Konicë dhe kufijtë me Shqipërinë (atje ku bashkohet Sarandapori me Vjosën) u takon fshatrave të mjeshtëreve (Mastorohoria) që janë të vendosura në të dyja anët e lumit. Zona e Vjosës që shtrihet nga vendi ku nis lumi deri në fushën e Konicës u përket fshatrave të Llakës së Vjosës në anën veriore të saj. Më lart zona e livadheve alpine të Gramozit dhe të Smolikas u përket fshatrave blektorale Vllehë. Në fund në luginën e Konicës, rreth e rreth fushës zhvillohet një grupim bujqësor kryesisht të fshatrave afër qytetit të Konicës. Le të shohim analitikisht të gjitha këto grupime që u krijuan dhe u zhvilluan historikisht dhe cilat janë karakteristikat e tyre kulturore dhe shoqërore.

Fshatrat e ustallarëve (Mastorohoria) të Sarandaporit e thonë me emrin e tyre janë të njohura dhe të famshme për mjeshtërinë ku sipas fjalës së urtë e «ndërtuan botën». Bëhet fjalë për një grupim fshatrash (rreth 40) të vendosura në zonën e dushkut me element bazë identifikimin në specialitetin teknik. Fshatra me origjinë bujqësor-blektorale, ku gjatë një casti kohor, falë një vështirësi ekonomike dhe demografike, kaluan në specializimin teknik, proces që do të ishte vendimtar për shprehjen e tyre kulturore dhe shoqërore. Të

---

[1] Për më shumë fakte në bibliografinë: shihe V. Nicakos, M Arapogllu, K. Karanacis, qarku i Janinës, Gjeografia kulturore moderne. N.A.I. Janinë 1998 dhe V. Nicakos, Konica dhe fshatrat e saj. Përbërja kulturore N. A. I. Janinë 2007.



gjitha fshatrat nxorrën mjeshtër të gurit, si kundër disa prej tyre u specializuan në arte të tjera, kështu që të emërtohen historikisht me to. Eshtë e njohur p.sh. shprehja: «Piktor je, Hionatidhis je» ose shprehja janjote «tani u bënë avokatët si në Burbian mjeshtrit».

Eshtë e njohur historikisht se këto fshatra u formuan si shoqëri kompakte gjatë shekujve të parë të mbizotërimit otoman. Deri atëherë ekzistonin banime të vogla të shpërndara me bazë sistemin e organizimit sipas fiseve të cilat u bashkuan për shkaqe organizative, tatimore dhe shoqërore. Rritja natyrore e popullsisë dhe vendosja e tyre e huaj në vazhdim provokoi një vështirësi ekonomike me rezultat të kërkimit të zgjidhjes nëpërmjet veprimtarive teknike.

Zhvillimi i teknikave të tilla profesionale karakterizoi për një farë kohe të gjatë jetën shoqërore të këtyre fshatrave me kulmin shekujt 18të dhe 19të. Vetëm në fund të shekullit të 19të fillon të bjerë ky fenomen, sepse vështirësohet përgjithësisht industria dhe vendi i Ballkanit «merr rrugën më të poshtë». Kështu lëvizjet periodike të mjeshtërve fillojnë të zëvendësohen nga udhëtimet e mërgimit d.m.th. qëndrim shumëvjeçar në vende të huaja si në Vllahi, Kostandinopojë, Egjipt dhe në Amerikë më vonë. Ky largim u fiksua në shtëritë e arhondëve, në urat harkore, në shkolla dhe kisha dhe në institucione bamirëse përgjithësisht duke dhëni një frymë të fundit dhe tek mjeshtrit që «nuhasin për së largu» pasurinë që hidhej nëpër fshatra.

Artet si punimi i gurit, punimi i drurit, druskalitja, ikonografia dhe pikturat ashtu siç u ushtruan me bazë profesionale, vulos jetesën dhe kulturën e këtyre fshatrave me rezultat identifikimin historik të tyre me ato dhe me krijimin e një vecorie vendore në të kaluarën që luan një rol përcaktues me kujtesën e përbashkët dhe të ndërgjegjësimit në të tashmën. Mjeshtërit e gurit në të gjitha fshatrat të njohur si kryemjeshtër dhe gurëskalitës nga Pirsojani, Burbjani, Kastanjani, drugdhëndësit nga Turnovo (Gorgopotamo), piktorë-ikonografë nga Hionjades, marangozë nga Liskaci (Asimohori), plujnë Ballkanin duke ndërtuar ndërtesa publike dhe private, duke gdhëndur ikonostase të kishave dhe manastireve duke pikturuar shtëpi arhondësh, duke lënë gjurmët e një arti popullor dhe të paaritshme në buste guri të kryemjeshtërve, në mbishkrimet me gabime ortografike të figurave «u ndërtua kjo kishë... etj» në një gjuhë të tyre emocionale ku nga karakteri i saj nuk duhej të ishte shkruar që të shuhet gradualisht në shkallët e ndërtimeve moderne. Veprat e tyre si ura e Konicës, ikonostasi i gdhëndur në dru i Shën Athanasit në Janinë,



pikturat në shtëpitë e arkondëve të Pilios dhe të Zagorit dhe një numër tjetër i madh monumentesh të artit popullor, ku fatkeqësisht akoma nuk është regjistruar, qëndrojnë si dëshmitarë të një të kaluarë që vlen për më tepër kujdes.

Madhështorja në artin e këtyre krijuesve «anonime» i përket kombinimit të përkryer të funksionimit praktik dhe estetik në respektin ndaj mjedidit natyror sipas të cilit i përshtaten veprat e tyre, ndjenjën e shkallës njerëzore dhe faljen përballë madhështisë, në vënien e shpirtit në çdo krijim që bën çdo gur të ketë zë në një harmoni dhe ekuilibër të brendshëm ku tregon për një përkatësi kolektive.

Gurë të gdhendur dhe të themeleve, streha dhe oxhaqe me pllaka të cara, themele guri dhe montime prej druri, relieve guri të skalitura të vëçanta me mbishkrime, simbole shtëpish, ikonostase të skalitura dhe tavane, baulle të gdhendura dhe të pikturuara, shkallë druri dhe kangjella, ikonografi nëpër kisha dhe ikona të lëvizshme, vizatime të brendshme nëpër shtëpi dhe gjithë ato krijime të dorës dhe të fantazisë të mjeshtrit me përvojë tregojnë trashëgiminë kulturore të këtij vendi. Dhe pas kësaj, në bazë të këtij fenomeni një prodhim origjinal plotësues, në duar kryesisht të grave, pak kopshte, ndonjë arë dhe ndonjë vresht pak kafshë shtëpiake, një ekonomi shtëpiake që fiksohet në terren me mure guri dhe taraca, gardhet dhe dushqet pa degë (për ushqim bagëtish) që qëndrojnë si monumente të natyrës dhe pylli i vogël për dru të domosdoshëm. Kjo është trashëgimia edhe pse në zhdukje mbijeton si në dhjetëvjeçarët e parë të pasluftës që drejtohej drejt braktisjes dhe tani afër me një tendencë rikthimi me një bosht kryesor të riredaktimit të kërkesës për zhvillim turistik.

Në Llakën e Vjosës rron peripecinë e vetë një grupim fshatrash me karakteristika të dukshme shoqërore, ekonomike dhe kulturore dhe me ndërjegjen e një grupimi të vogël. Me përjashtim të fshatit Eleftero (Grisbani) që nga ana kulturore duhet t' bashkohet Mastorohoriave (edhe ky fshat mjeshtrë nxirrte), fshatrat e tjera të Llakës të vendosura gjatë lumit vjosë, zhvilluan një kulturë të vecantë vendore me bazë pyllin dhe bujqësinë duke e plotësuar me blektori shtëpiake. Zona midis shtëpive dhe lumit, poshtë dhe nëkrahë të ujërave është vendi i kultivimit bujqësor që natyrisht në të kaluarën shtrihej në veri të vendbanimeve, ku kultivonin kryesisht drithërat e nevojshme. Mbivendbanime ka zona të pyjeve të mbrojtura, të shkurëve dhe livadheve dhe më tej pyje të mëdha që përbëjnë edhe sot një faktor të rëndësishëm të ekonomisë së vendit.



Karakteristikat kulturore bazë të banorëve të Llakës së Vjosës është origjina e tyre vllehe dhe specializimi në profesionet e pyllit. Sharrxhinj, qymyrxhinj dhe katramaxhinj lëvizin në një hapësirë të madhe gjeografike duke ushtruar profesionet e tyre. Sharrxhinjtë me vegla teknike bazë sëpatën dhedhe sharrën e thjeshtë që e punojnë dy veta ndërtuan vetë më vonë që punojnë me ujë në krahë të lumenjve dhe përrenjve duke formuar një kulturë teknike paraindustriale të shkëlqyer, por dhe një mënyrë jetese të vecantë. Qymyrxhinjtë ngrenë furrat e tyre dhe kasollet ku banojnë sipërfaqe pyjore me dru të përshtatshëm për qymyr duke zhvilluar dhe ata traditën e vogël të tyre. Përsa u përket katramaxhinjve ata mbahen mend në kujtesën e njerezve si reklamues tipikë të produktit të tyre, të cilin e shesin me thasë lëkure që e ngarkojnë në kafshët e tyre. Katrani prodhohet nga pisha (pemë me përbajtje të lartë rëshire), përmes djegjes në furra të vecanta. Përdoret akoma sot pr në sasi të vogla nga blektorët për qëllime shërruese mjekësore (kryesisht për shërrimin e plagëve), ndërsa më parë përdorëshin për rrotat e qerreve ku për këtë katramaxhinjtë qarkullonin mjaft në vende si Maqedonia ku kishte shumë qerre. Është karakteristike se banorët e fshatit Distrato akoma dhe sot emërtohen «katramaxhinj».

Zona e Llakës së Vjosës nxori gjithashtu mjaft qiraxhinj, samarxhinj dhe mullixhinj. Njohuritë teknike të tyre janë të ndryshme nga ato të Mastorohoreve, që lindën nga të njëjtat nevoja kryesore bujqësore – blektorale dhe të ekonomisë së pyjeve për t'u bërë përfundimisht një karakteristikë e vecantë e këtij grupimi gjeografiko–njerëzor.

Sigurisht mërgimi edhe këtu luajti rolin e vetë dhe kishte ndikimet e tij në shoqërinë vendore. E njëjta gjë edhe për emigracionin në vitet më të reja ku bashkë me luftërat (këto fshatra kishin fatin e keq të shkatëroheshin nga gjermanët) ndikuan në rënie dhe braktisje. Me gjithë këto të paktën Distrato është akoma një shoqëri e gjallë me perspektiva jetese, por dhe të ringjalljes së qelizave të saj prodhuese.

Ror jashtë kësaj kulture të vecantë dhe të shkëlqyer, jashtë teknologjisë tradicionale, këto fshatra zhvilluan dhe forma të veçanta të shprehjes kolektive dhe të krijimtarisë të fiksuar në lloje të ndryshme të kulturës popullore vendore. Në kufijtë e Epirit dhe të Maqedonisë Përendimore dhe mbi një rrugë historike kalimi lëvizin dhe kanë një komunikim të vazhdueshëm me fshatrat e tjera vllehe të Pindit dhe formojnë një sistem kulturor vendor ku dikush mund të thotë se shpreh piktakimin e traditës së Konicës me atë të Maqedonisë Përendimore. Kjo duket vecanërisht në traditën muzikore tek e cila



mbizotërojnë «gajdat» me prejardhje nga Maqedonia dhe përshtatja Epirote me vecoritë e vecanta të Pindit. Nga ana e veshjes gjithashtu vihen re fenomene të kryqëzimit të traditës vllehe me atë koniciote. Vallet e mëdha nëpër festaë përbëjnë shprehjen më të lartë kolektive tradicionale në këto fshatra fiksojnë elokuencën e të gjitha karakteristikave të shoqërisëlokale, por dhe zhvillimet që ndodhin gjatë kohës.

Lart në zonën e kullotave alpine gjenden prej shekujsh blektorët vllehë. Më shumë Aetomilica dhe më pak Furka janë raste karakteristike të grupimeve të vogla në komunitete që zbrazen në verë, sepse kopetë zbresin në kullotat e Thesalisë dhe të Maqedonisë. Të inkuadruara në një grupim më të madh të fshatrave vllehe tëPindit këto dy komunitete shtojnë vecantinë e tyre në mozaikun e kulturës vendore. Janë vllehërit që dinë se kalojnë dy herë në vit nga mali në fushë dhe anasjelltas, janë vllehërit me karvanët e mëdhenj, qeraxhinjtë që transportojnë produkte dhe njerëz, janë vllehërit që mbushin pazaret me velenxa me thekë, bruca dhe lloje djathi (kackavall, etj) janë vllehërit me kulturën e stanit. Ndërsa Furka paraqet të dhëna të ekonomisë së bashkuar në blektori dhe bujqësi, gjithashtu dhe disa forma të specialitetit teknik (marangozë, rrobaqepës ) Aetomilica është një fshat blektoral i pastër akoma dhe sot. Gjithashtu duhet të theksojmë se Furka njohu një emigracion të madh me rezult boshlleku demografik që u krijua të plotësohet me vendosjen në fshat të Arvanito-vllehëve blektorë që përbëjnë trungun kryesor të popullsisë së fshatit sot.

Vllehët blektorë kanë jetën e tyre ekologjike që i përket veprimtarisë së tyre prodhuese që e dikton përshtatja kogkrete, mënyra kokrete e jetesë në bazë të së cilës krijohet dhe një kulturë e vecantë. Administrimi kolektiv dhe ndarja e kullotave një tradite të vjetër etë drejtë, ekuilibri mes shoqërisë njerëzore, kapitali i blektorisë dhe pasuritë dhe pasurisë natyrore të disponueshme, plotësimet e blektorisë, avlimentet e shtëpisë, marrëdhëniet me kopenë që shrehet me forma të shumta të shprehjes shoqërore dhe kulturore, jeta në shoqëri dhe në stan përbëjnë një bashkësi shprehjesh me më të theksuar kohëzisionin e bre ndshëm. Ky kohëzision shpjegon dhe vazhdimin e rëndësishëm në kohë të disa përbërësve arkaikë që rezistojnë akoma me gjithë ndryshimet në karakteristikat «teknike» të veprimtarisë së prodhimit blektoral.

Kultura baritore e vllehëve blektorë shpjegon një pamje të vecantë të historisë lokale. Vetë këta blektorë bashkë me Sarakacanët kanë qënë gjatë shekujve ndërmjetësit



midis malit dhe fushës pasi lëvizjet e tyre krijojnë gjithmonë kontakte ndërveprime dhe shkëmbime. Këta «të mbyllurit» dhe konservatorë ndër të tjera baritorë ishin në mënyrë të padiskutueshme mbartës të kulturave dhe mesazheve nga vende të tjera, importues të produkteve shpirtërore dhe materiale nga kullotat dimërore, por dhe nga vendet që kalonin. Në Aetomilicë p.sh është venë re me kujdes sot shfaqja e melodive pondiake nëpër festa, ashtu të dukshme janë dhe ndikimet analoge gjuhësore tek banorët vendas, gjë që i detyrohet një bashkëjetese të një pjese të madhe të popullsisë me pondet në vendet e ulëta të Maqedonisë gjatë muajve të dimrit. Kultura baritore malore e vllahëve është akoma e gjallë duke treguar duke treguar një qëndrueshmëri të admirueshme dhe përshtatje në kushtet e reja.

Dhe nga malet e larta nga vllahët baritorë le të zbresim përsëri më poshtë, në fushën e Konicës ku dhe kjo shkruan historinë e vetë me kolonët e saj më herët kur ajo u takonte bejlerëve dhe kultivuesit modernë sot mes të cilëve shumë refugjatë nga Azia e Vogël.

Vetë qyteti i Konicës është bazuar dhe bazohet në prodhimin e saj origjinal të fushës, por gjithmonë ekzistonte dhe një pazar, një treg dhe një qendër industriale. Kultura e Konicës është mbi të gjitha kultura e një pazari. Vetë ndërtimi i shtëpive të saj fiksoi bazat e saj të funksionimit, por dhe përbërjen shoqërore që rezultoi nga ato. Para çlirimit shtresat shoqërore të Konicës i përbënin bejlerët dhe çifligarët tregtarët dhe artizanët dhe sigurisht kultivuesit e fushës. Këto shtresa kishin një vendosje konkrete në ndërtimin e vendit që shfaqte një dallim të dukshëm dhe hierarki. Ata që i jepnin «ngjyrën» pazarit ishin natyrisht artizanët që kishin punishtet e tyre brenda territorit të pazarit në krahë të tregtarëve, këpucarëve, rrobapësve, gunabëresve, hekurpunuesve etj.

Gjithë kjo klasë shoqërore u përmbys pas çlirimit pasi ikën bejlerët dhe filloi të bjerë artizanati, gjithashtu u vendosën në Konicë refugjatët nga Azia e Vogël dhe shumë familje Vorioipirote kryesisht nga Leskoniku. Filloi gradualisht një riorganizim demografik shoqëror dhe kulturor që do të plotësohet në vazhdim me emigracionin e brendshëm të një popullsie jo autoktone dhe me ardhjen nga ana tjetër të njerëzve nga fshatrat e periferisë, kryesisht pas luftës civile dhe deri në këto vitet e fundit.

Konica ekzistonte gjithmonë një qendër, por dhe një kalim. Ishte një vend i ardhjes dhe i takimeve të elementeve të ndryshëm kulturorë, një vend me funksione katalizatori për



i përket përzierjes mes njerëzve dhe kulturave të ndryshme. Pazarit vjetor «Pazaropullo» çdo vjeshtë në kohën që largoheshin blektorët nga malet përmbledhte të gjitha funksionet e qytetit ku përfundimisht u bë simboli i bashkimit brenda nga ndryshimet, gunaberësit koniçiotë, argjentarët nga fshatrat vllehe, kallaxhinjtë nga Çamandaja endëse nga fshatrat vllehe, jevgj qelepërshinj etj. Bashkoheshin në rrugicat e ngushta të pazarit dhe në shumë hane duke krijuar një atmosferë interesante të shprehjes kulturore dhe të shkëmbimeve, ku e përshkruan mjaft goditur dhe bukur J. Liberopullos në librin etij «Anatomia e Pazarit».

Pazarit filloi të degradohet bashkë me artizanatin. Tregu dhe ekonomia përgjithësisht kanë ndryshuar. Gjithashtu Konica vazhdon ta luajë rolin e saj, qoftë dhe me kritere të tjera. Konica është një qendër administrative është një qytet që ofron shërbime më shumë sot, por funksionon akoma si një treg lokal për komunitetet rreth saj duke tërhequr çdo ditë shumë njerëz. Ajo funksionon akoma si një qendër simbolike si një vend që bashkohen në mënyrë krijuese disa tradita të rajonit sa më gjerë.

Tradita e Konicës është pazarit dhe gjithë ajo kulturë para artizanale që zhvillohet rreth saj. Tradita e Konicës është funksionimi i mirë në lidhje me periferinë e saj është se kanë marrëdhënie midis tyre dhe se traditat e ndryshme bashkëjetojnë në mënyrë krijuese. Me bazë këtë traditë integrohen dhe përparojnë të ardhurit nga Azia e Vogël (Mistiotës dhe Farashotës) duke e transformuar fushën e saj në një parajsë të vogël bile me identitet të veçantë në produktet që prodhon, ashtu sikundër integrohen dhe Vorioipirotet dhe fshatarë të tjerë që vijnë nga komunitetet rreth saj.

Përreth fushës zhvillohen dhe fshatrat bujqësore ku historikisht kishin rrugën e tyre të vështirë të lidhur me historinë e çifliqeve, por tani kanë një rritje ekonomike dhe një gjallëri shoqërore relative duke tejkaluar problemin e rrallimit demografik me emigracionin e jashtëm të pasluftës bile duke regjistruar edhe në një valë të rëndësishme riatdhesimi, e cila është e dukshme edhe në terren me banesat e reja të emigrandëve (rast karakteristik është Aetopetra). Fusha në përgjithësi do të mund të thoshim zhvillon sistemin e vet gjeografiko-njerëzor me një dinamike moderne me kusht specializimin me prodhime ekologjike ose «prodhime të identifikuar» prodhime të cilat mund të dendësojnë dhe të shprehin elementë të traditës lokale dhe ku natyrisht janë të përshtatura në veçoritë ekologjike të vendit.




Të dyja fshatrat pë gjenden matanë lumit në shpatet e Nemerçkës Aidhonohori (Ostanica) dhe Molivdhospepasti (Dhepalica) historikisht i takonin Pogonit, por me kalimin e kohës u përfshinë administrativisht në Komunën e Konicës dhe zhvilluan marrëdhënie të larmishme me të, zhvilluan madje një ndërgjegje koniçote. Element karakteristik i këtyre fshatrave është besimi në fe. Me dy manastire të rëndësishme atë të Gurrës në Ostanica dhe të Shën-Merisë ne Dhepalica ashtu si dhe kishat e panumërta dhe vakëfe ky vend paraqet një hapësirë metafizike të theksuar si terren veçanërisht tradita e manastireve të këtij vendi me rrezatimin e njohur të tyre si dhe traditat fetare të tyre do të mund të luante një rol të rëndësishëm për një zhvillim modern të këtyre fshatrave.

Kjo është në vija të përgjithshme mozaiku i kulturës së rajonit të Konicës, një mozaik që nxjerr unitetin nga ndryshimi dhe auasjelltas ndryshimin nga uniteti. Tradita e muzikës është një shembull i mirë që vërteton akoma edhe sot Konstatimin e mësipërm. Ekziston veçse një e veçantë në shprehitë muzikore që shpreh gjithë rajonin, por që ndryshon nga një bashkësi në një tjetër ose akoma nga një fshat në tjetrin. Rast karakteristik është vallja «gajda» pë interpretohet me mënyra të veçanta nga një fshat në tjetrin (p.sh. gajda padhjote, gajda pirsojanitjote etj.). Në muzikë fiksohet gjithashtu fakti se rajoni është një udhëkryq kulturor mes Shqipërisë dhe Maqedonisë Perëndimore. Ndikimet nga të dy vendet janë të dukshme. Ndikimi «Shqiptar» («Karamutjate») të çon me tepër në të kaluarën (se dhe familjet e mëdha Çuta, Panusaku e kanë origjinën nga Leskoviku), ndërsa ndikimet nga Maqedonia Perëndimore janë të tanishme.

Përgjithësisht tradita muzikore e Konicës është një tregues i mirë i veçantisë së rajonit dhe shpreh gjithashtu ndikimet e ndryshme dhe këmbimet që kanë ndodhur në terren dhe në kohë. Akoma dhe sot, pasardhës të familjeve të mëdha muzikore (Bexhenjtë, Aleksi, Halpiatë, Panusakët) janë aktivë dhe të gatshëm pë të interpretojnë pë ata pë dinë të kërkojnë «pekllarin», «zermatino», «dadon», «bilbili», «leskoviqaren» dhe kaq të tjera këngë koniçote «të tyre».





**PËRMET** Zona e studimit në anën e Shqipërisë përmban analogët me zonën e Konicës, një seri bashkësish kulturore të cilat i përshkon lumi i Vjosës (Aoos ) duke kaluar në krahë të masivit malor të Nemerçkës fillimisht dhe të Dhembelit në vazhdim duke arritur deri tek vendi ku lumi pasurohet me degën e Lomnicës afër fshatit Piskovë. Në këtë pikë mbaron zona e Vjosës së sipërme pak para se lumi të kalojë ngushticën e Këlcyrës dhe të bashkohet me degën tjetër të lumit Drino dhe të derdhet në detin Adriatik pak më në veri të Vlorës.

Historokisht lugina e Përmetit përbën një kalim që lidh Shqipërinë qendrore dhe bregdetare me detin Egje dhe Stambollin dhe u përdor nga të gjithë perandorët duke i kërkuar ato rrugë që do të mund të lidhnin Ballkanin lindor me atë perëndimor. Kjo rrugë njohu zhvillim të veçantë në fund të shekullit të 18të dhe në fillim të shekullit të 19të kur marrja e pushtetit nga Ali Pashë Tepelena, pashai i Janinës lehtësoi formimin e një rrjeti komunikimi me ura, hane dhe pika kontrolli.

Thuajse të gjitha fshatrat e luginës (Buhali, Lipa, Lashica, Lensa, Strëmbeci, Draçova, Zhepa, Biovizhda, Iliara, Trebozhisti, Lipivani etj.) janë ndërtuar në rrëzë të kodrave, pak më larg se rrugët qendrore ose dhe pas kodrave (Koludhi, Kanikoli, Gjinkari, Qilarishti) kështu për të pasur relativisht një mbrojtje nga ushtritë lëvizëse. Pas ndryshimeve të thersuara në fund të shekullit të 19të dhe në fillim të shekullit të 20të një rrymë











zhvendosjeje drejt lumit dhe arterieve rrugore, rrymë që reflekton zhvillimet shoqërore e politike të një rajoni ku nga një pjesë e përandorisë shumë etnike kthehet në një rajon kufitar midis dy shteteve kombe.

Qendra bazë e rajonit ishte dhe mbetet qyteti i Përmetit. I ndërtuar 260m mbi nivelin e detit në bregun përendimor të Vjosës në një largësi 35 Km nga kufiri përbën tradicionalisht qëndrën e rajonit më gjerë. Veç Përmetit zona më e gjerë e luginës mund të ndahet në bashkësi gjeografiko-njerëzore si më poshtë:

1. në zonën Cerie që përmban vendbanime në të dyja brigjet e lumit Lomnica me kufi verior Bredhin e Hotovës dhe malet e Dangëllisë, në juglindje degën tjetër të lumit të Vjosës, Lingarica, ndërsa kufiri përendimor i zonës përcaktohet nga vetë lumi i Vjosës. Në këtë zonë përfshihen fshtrat: Raban, Pagri, Odriçan, Hotovë, Kosovë, Gosnisht, Tremisat, Zlenshë, Mokricë, Lupekë dhe Nokosela. Në renditjen e inçizimeve në këtë zonë përfshihen dhe disa fshatra që gjenden më afër lumit Vjosë dhe në kufijtë e kësaj zone dhe që janë fshatrat: Kutal, Kosinë, Bodar dhe Qilarisht.
2. në zonën Shqeria me kufi verior lumin Lingarica deri tek perroi i Dardhësit, me kufi përendimor lumin Vjosë ndërsa nga lindja i afrohet Leskovikut. Fshatrat e kësaj zone janë Ogdunan, Delvinë, Kreshovë, Lipivan, Trebozisa, Melan, Iggar, Kovaçisht dhe Benjë.
3. zona Rrëza që përhapet në rrëzë të malit Nemerçkë në bregun përendimor të Vjosës tek e cila i përkasin fshatrat: Gjinkari, Pefrani, Mesukari, Kaludhi, Strëmbeci, Pëllumbari, Kanikoli, Draçova, Zhepa. Në këtë bashkësi vendosen dhe dy fshatra minoritare greke, Vllahopsillotera dhe Valovista edhe pse historikisht ishin pjesë e zonës së Pogonit një zonë që ndodhet në jugpërendim të zonës që studiohet dhe ndohet midis Shqipërisë dhe Greqisë. Gjithashtu të njëjtës zonë i përkasin dhe fshatrat Çarshovë dhe Iliara edhe pse që të dyja ndodhen në bregun lindor të lumit Vjosë.
4. me në fund kemi zonën Qendra që është zona e qytetit të Përmetit bashkë me disa fshatra që ndodhen në rrëzë të malit Dhembel dhe që janë Buhali, Lipa, Lensa dhe Leshica.

Këtu duhet të nënvizojmë se ndarja e mësipërme përmban zona me karakteristika dalluese dhe me një autonomi relative. Bashkime administrative dhe zhvillime shpërore ekonomike si ishte bashkimi i këtyre zonave në kooperativa bujqësore (njësia bazë ekonomike në



fushën e bujqësisë gjatë qeverisjes nga Partia e Punës të Shqipërisë) përafruan relativisht në disa raste kuptimin etnografik të zonës, kuptim i cili është historik dhe konkret. Për sa më lartë qëndron dhe vëzhgimi se veç fshatrare që ripërmendëm më lartë në këto zona ekzistonin edhe fshatra të cilat sot janë braktisur janë Melani, Devojar, Dardhës, Mesukar, Kreshovë, Izgar, Kovaçisutis, Vinjia, Zerec, Aroriçani, Serani, Perati. Shkak për këtë janë kushtet konkrete historike si pjesë e ndryshimeve shoqërore e politike. Kështu p.sh. dy fshatrat e fundit pushuan se ekzistuari për shkak të afërsisë me kufirin politik, afërsi e cila e bënte problematike kontrollin e tyre nga ana e shtetit pas mbylljes hermetike të kufijve në vitin 1945.

Qyteti i Përmetit që është pikë referimi i zonës njohim se ekziston nga shekulli i 15të kur është ndërtuar kalaja e Kodrës së Bolengës rreth së cilës dhe dy xhami do të zhvillohet më vonë qyteti. Në fund të shekullit të 18të dhe të 19të në kulm të qeverisjes nga Ali Pashai i Janinës, qyteti numëronte 4500 me 5000 banorë dhe përbënte stacion në rrugën tregtare që të çon në Vlorë, drejt përendimit dhe në Maqedoninë Qendrore në Selanik dhe në Stamboll drejt lindjes. Pas shpartallimit të Ali Pashait nga Porta e Lartë gjatë gjithë shekullit të 19të dhe gjysmën e parë të shekullit të 20të popullsia e Përmetit nuk do të kishte rritje dhe do të mbetej në ato përmasa.

Lufta e dytë Botërore kishte pasoja të rënda për rajonin veçanërisht për Përmetin, pasi qyteti u dogj tri herë nga forcat e Boshtit gjë që detyroi një numër të madh banorësh të emigronin dhe si rezultat në fund të Luftës qyteti të mos i kalonte të 3000 banorët. Në vazhdim popullsia e qytetit do të ndiqte ritmet e larta të zhvillimit të të gjithë Shqipërisë ku me regjistrimin e vitit 2001 të arrinte numrin e 14000 banorëve, nga të cilët gjykohet se 3000 kanë emigruar jashtë shtetit (Kryesisht në Greqi). Në mjedisin e ndërtuar, në kujtesën kolektive të përmetarëve si dhe në arshiva janë të regjistruara ndryshe figurat e një të kaluarë në lagjen që ndodhet në pikën më të lartë të qytetit (në përendim) dallojmë shtëpi karakteristike të shekullit të 19të me mure të larta guri, dykatshe ose trekatshe me magazina të mëdha dhe stalla, dhoma (oda) të larta me tavane veçanërisht të zbukuruar, dëshmitarë të zhvillimit të qytetit në të kaluarën. Referim i veçantë këtu ia vlen t'i bëhet shtëpisë së Efthim Dukës, djalit të mësuesit të njohur Kostandin Duka që u ndërtua rreth viteve 1830.

Karakteristikë tjetër e këtij qyteti është shkëmbi i lartë që ekziston në qendër të qytetit



të Përmetit nga ku shikohet e gjithë lugina. F. Pouqeville, konsull francez në Janinë dhe vizitor në vitin 1807 e përshkruan si shkëmb gëlqeror kur një çast ra nga mali i Dhëmbelit që e përdornin si pikë vrojtimi për kontrollin e karvanëve që kalonin në luginë.

Karakteristikë shumëvjeçare e Përmetit (por edhe të të gjithë rajonit) është eterogjenia e popullsisë së saj që përbëhet nga grupime etnike që njihen nga të tjerët por që njohin edhe vetvetën si të tillë. Konvencionalisht dallimi bëhet me terma fetare, gjuhësore apo origjinë por fakt është se këto karakteristika nuk përcaktojnë qendrushëm kategori që përjashtohen dhe këto grupime duhet të përballohen në dinamikën e tyre konkrete dhe në marrëdhëniet që zhvillojnë midis tyre. Kështu në qytet ekzistojnë myslymanë dhe të krishterë orthodoksë ka gjithashtu dhe romë (orthodoksë dhe myslymanë) si dhe vllahë (orthodoksë) këta të fundit ruajnë veçorinë e tyre gjuhësore veçanërisht kur u detyruan nga kushtet shoqërore e politike të vendosen fillimisht në fshatra afër Përmetit (Kosinë, Kutali, Leshicë, Leusë) dhe më vonë dhe brenda në qytet. Natyrisht kur afrohet njëri sa me afër, aq dhe pamja duket më pastrër, dhe shpallen dhe kategori të tjera të ndërmjetme, ndërsa integrimi i njërit apo tjetrit person në një grupim ka gjithmonë elementin e strategjisë personale, natyrisht brenda kufirit të kuadrit konkret. Kështu ka p.sh. ata tek të cilët u njihet origjina e tyre vllahë por që nuk ruajnë elementin e gjuhës. Megjithatë konkretisht mund të shprehen dhe të deklarohen ndaj të tretëve «Vllahërinë» e tyre me qëllime konkrete. Ajo që është e rëndësishme të theksohet është tradita e tolerancës në rajon dhe në vetë qytetin si dhe bashkëjetesa e të gjitha besimeve dhe grupimere etnike.

Përsa i përket bashkëjetesës fetare rol të rëndësishëm ka luajtur prania e një numri të madh bektashinjsh myslymanë. Është fjala për një rrymë fetare që u nis nga Lindja, gjeti tokë të pasur në Shqipëri ku dhe u zhvillua dhe si rezultat sot konsiderohet Qendra e Bektashizmit Botëror. Karakteri i Bektashizmit që është toleranca, favorizoi marrëdhëniet midis të Krishterëve e Myslymanëve, gjë që e përforcoi dhe qëndrimi ateist i regjimit të kaluar. Vitet e fundit bëhet një përpjekje nga ana e drejtuesve lokalë që të shpallet kjo karakteristikë e qytetit me organizimin e një festivali folklorik «multikulturor» tek i cili marrin pjesë grupe folklorike që përfapësojnë grupime etnike të Shqipërisë dhe më gjerë të Ballkanit.



Në kuadrin e qeverisjes komuniste të vendit, Përmeti edhe pse qytet i vogël u investua simbolikisht nga regjimi me pretekstin kryesisht të rolit që ka luajtur qyteti dhe rajoni në organizimit e Frontit Antifashist Nacional – Clirimtar kundër gjermanëve. Në maj 1944 në Përmet u organizua Kongresi Antifashist Nacional – Clirimtar nga i cili u zgjodh Qeveria e Parë Demokratike. Festimi i kësaj ngjarjeje i jepte mundësinë Përmetit që për disa ditë të bëhej «Kryeqyteti i Shqipërisë» Përmbajtja festive nuk i kushtohej vetëm Luftës Antifashiste, por më gjerë duke dhënë mundësinë për një paraqitje totale të kulturës popullore të vendit.

Lulëzimi që njohu qyteti gjatë periudhës midis dy luftërave me zhvillimin e profesioneve të artizanatit krijoi një traditë qytetare të punës së dorës e cila u zhvillua në kuadrin e ndërmarjeve shtetërore me qëllim eksportin. Gjithashtu u krijuan prodhime të vendit me emër veçanërisht të njohura në gjithë Shqipërinë.

Ky lulëzim kapitalizon për gjithë rajonin përfitimet e emigrimit nga rajoni drejt Përandorisë deri në inkadrimin e rajonit në shtetin shqirtar, emigracion që në vazhdim do t' i drejtohej vendeve të tjera kryesisht drejt Amerikës. Kjo vërejtje është veçanërisht e rëndësishme që të kuptojë ndokush thellësinë historike të emigrimit modern. Është karakteristike habia e partizanëve gjatë Luftës kundër gjermanëve ku në shtëpitë e banorëve në Shqeria që i mikpritnin shikonin të shkruara në çarçafët e tyre «made in Japan» e cila vërteton lidhjet ndërkombëtare të një vendi ku rastësisht gjendet simbolikisht jashtë vëmendjes.

Karakteristikë ishte dhe ndikimi i kontributeve financiare të emigrantëve aq sa dhe influenza dhe të elementeve arkitekturore që tregojnë për një traditë arkitekturore lokale. Paralelisht emigrimi krijon që nga gjysma e shek të 19të një rrymë idesh të reja politike në rajon. Kështu rajoni i Përmetit bëhet qendër e prodhimit dhe propagandimit të Rilindjes Kombëtare nga vëllezërit Frashëri, fshat i rajonit të Përmetit.

Një anë tjetër që karakterizon rajonin janë urat e shumta që sigurojnë komunikimin ndërmjet dy anëve të lumit Vjosë. Këto ura jashtë përdorimit të tyre të dukshëm, krijojnë një unifikim në rajon dhe vijnë në kundërshtim me praktikat politike mohuese. Për këtë dhe lokalisht është e forte përmbajtja simbolike e urave. Shembull karakteristik është





ura e vjetër e shembur në rajonin e tri urave shumë afër urës së sotme–kufiri midis Greqisë dhe Shqipërisë për të cilën kemi regjistruar këngën konkrete. Atje secili mund të dëgjojë çarje të historisë zyrtare kombëtare përderisa flet për marrëdhëniet midis dy fshatrave të cilat sot janë zhdukur, një fshat krishter në anën shqirpare dhe një fshat shqiptar, myslyman banorët e të cilit emigruan drejt Shqipërisë duke e braktisur atë. Kështu mbi një motiv ballkanik të njohur, analog me atë të urës së Artës, zhvillohet dhe regjistrohet historia e tij.

Diçka analoge me ndarjen gjeografike të punës që pamë më lart në rajonin e Konicës kishim dhe në rajonin e Përmetit. Në qytetin e Përmetit, profesion i njohur është i hekurpunuesit që zakonisht ushtrohet nga romët. Shumë të njohur ishin dhe kopshtarët e zonës që i dedikohet famës dhe specializimit të tyre në fakt ata punonin në kopshtet e Përandorisë së Kostandinopojës, ku ky punësin i tejkalonte caqet e nivelit lokal.

Gjithashtu të famshëm ishin rrobaqepësit nga Kosina, nga Qilaristi dhe nga Lensa, druvarë nga fshatrat Kaludhi Strëmbeci, Kanikoli dhe Zhepa. Druvarët bashkonin zonën pasi lëviznin në malësitë e zonës, në pyjet e Hotovës dhe të Frashërit (sot park kombëtar) nga ku në vazhdim transportonin drutë që i përdornin kryesisht për ndërtime (trarë për shtëpi). Fshat i njohur për samarxhinjtë ishte kryesisht Qilaristi, ndërsa fshati Buhali ishte pikë referimi për mjekët popullorë që lëviznin deri në Janinë.





Tradita muzikore e Përmetit përbën veçanërisht pikë referimi me muzikantë dhe këngëtarë shumë të njohur në nivel kombëtar siç janë Laver Bariu Medi Përmeti Mentor Xhemali, Afize dhe Selim Leskoviku dhe shumë të tjerë. Kjo traditë është kryesisht traditë e romëve dhe përmes ekspozimit të saj u inkadrua në kulturën kombëtare shqiptare ashtu siç u institucionalizua gjatë qeverisjes së Partisë së Punës të Shqipërisë. Por jashtë kësaj «tradite» të formës muzikore të këngëve polifonike dhe të orkestrave, një pjesë e madhe e krijimtarisë muzikore vendase i kushtohet dhe këngës qytetare që njohu zhvillim të veçantë gjatë periudhës midis dy luftërave, me ndikime nga tradita muzikore analoge të Korçës.



Vend / Kulture / Identitete: nga brigjet e Vjoses ne internet  
Duke luajtur me muyikën dhe fjalët





## Kufiri dhe emigracioni

---

Cilado përpjekje për të kërkuar karakteristikat e fizionomisë të rajoneve kufirare të Epirit qysh nga shekulli i 20të deri tek shekulli 21të, është e padiskutueshme të përballojë dy parametra që lidhen midis tyre, ku njëkohësisht tregojnë përmasat karakteristike të historisë moderne të rajonit më gjerë. Parametri i parë i kushtohet vetë karakterit kufitar të rajonit ashtu siç ai u formua me vendosjen e kufirit greko-shqiptar gjatë luftërave ballkanike ku me kalimin e këtij shekulli e vendos Epirin si vendin e mikpritjes dhe të vendosjes së emigrantëve shqiptarë, ndërsa në shekullin e kaluar dhe gjatë periudhës midis dy luftërave ishte një vend i emigrimit të emigrantëve në vende të tjera.

Kufijtë kombëtarë janë relativisht të tanishëm në këtë rajon dhe u përcaktuan me vështirësi të madhe falë karakterit kompleks etnologjik dhe të pamundësisë së përcaktimit të një korrespondimi absolut ndërmjet grupimeve etnike konkrete dhe të riformimit të ndarjes etnike. Jashtë faktit se përcaktimi me forcë i kufijve krijoi ngjashmësi në krahinat kombëtare në të dyja anët e kufirit dhe rasti më i bujshëm i njohjes zyrtare të minoritetit grek në jug të Shqipërisë ku me vështirësi secili do të mundte të barazonte grupimet etnike ekzistuese absolutisht me njëren ose tjetren kombësi, pasi ekzistonin



kategori të ndërmjetme që kombinonin karakteristika të veçanta por që bashkëjetonin historikisht për shumë shekuj akoma dhe në të njëjtat fshatra në kuadrin polietnik të Përandorisë Osmane, e cila si është e ditur njihete dallimin e popullsisë në «milet» me kriter bazë besimin<sup>2</sup>.

Vendosja e kufirit etnik midis Greqisë dhe Shqipërisë shënonte dhe integrimin e detyrueshëm të të gjitha grupimeve etnike në një kategori kombëtare nga të dyja shtetet, integrim i cili me radhën e tij do të shënonte dhe procesin e homogjenizimit me bazë ndarjen në grek edhe shqiptarë. Nga ana tjetër terreni geografik që funksionoi si një i terë për shekuj me radhë u nda bile pas luftës së dytë botërore njohu atë që quhet «perde e hekurt» dhmth mbylljen përfundimtare të kufirit dhe ndalimin e të cilit do komunikim ndërmjet popullsisë në të dyja anët e kufirit. Kjo gjë vazhdoi për disa vjet, qysh nga vendosja e regjimit të Hoxhës deri në rënien e tij në vitim 1991.

Rajoni i Konicës jetoi gjithashtu fort, bashkë me zonat e tjera të Epirit (Pogoni, Zona e Filiatit) këtë ndarje të vendit. Fshatra dhe grupe popullsisë që prej shekush kishin marrëdhënie të ngushta si p.sh: Konica me Leskovikun, Plikati me Rahovën, Molivdhoskepasti me Vllahopsilloterën. Vetmohen grupime të afërmish, akoma dhe familje jetojnë ndarjen me forcë, shkëmbime ekonomike të gjëra, jeta shoqërore, ndërpriten kontakte kulturore, grupe profesionistësh që lëviznin si ustallarë dhe blektorë nomadie, nuk mund më të çajnë kufirin dhe ndryshojnë kështu rrugët tradicionale të ndëtimeve të tyre, të kufizuar gjë për kishte pasoja të rënda për vetë fatin e tyre, në kufirin midis dy shteteve etnike ashtu si ato u ripërcaktuan me vendosjen e kufinjve.

Rënia e regjimit të mëparshëm komunist në Shqipëri çoi në rënien e «perdes së hekurt» dhe në esencë në një hapje të dhunshme të kufijve shqiptaro-greke ku nga një anë tjetër mund dikush të mbështesë se kjo gjë të çon në rivendosjen graduale të unitetit historik të humbur të vendit. Shumë grupe dhe mënyra ekonomike shkëmbimesh u rikthyen në

---

[2] Shiko L. K. Hart 1999 «Culture civilisation and demarcation at the north west of Greece», American Ethnologist, 26 (1) fq. 196-220 dhe Th. Veremis-Th. Kulumbis –H. Nikollakopoulos 1995, Greqët e Shqipërisë, I. Sideris-Athinë.



funksionim edhe pse me forma dhe pamje të ndryshme marrëdhënie shoqërore të vjetra akoma dhe lidhjet familjare u rivendosën, monopate të harruara u rikthyen dhe kufiri etnik që për shumë vjet përfaqësonte ideologjinë e izolimit dhe tragjedinë e kundërshtimit etnik për u diktua në popullsi të tyre, përfytyrohet tani një vijë e çuditshme që ruhet nga ana e Greqisë nga rojet e kufirit. Njerëz, kafshë dhe të mira materiale lëvizin nga njëri fshat tek tjetri duke çarë kufirin, kalojnë d.m.th. nga një shtet tek tjetri akoma dhe brenda një dite duke krijuar tani një vend ndëretnik atje ku dikur ekzistonte një vend vetëm.

Një konstatim i përgjithshëm i parë që i takon lëvizshmërisë së madhe ndërmjet dy anëve të kufirit dhe sigurisht me afërsinë geografike. Në poftë se gjendet dikush në fshatim Molivdoskepasto<sup>3</sup> në një mbasdite të çfarë doshme do të shikojë njerëz të moshave të ndryshme të zbresin nga autobuzi për vjen nga Konica dhe me këmbë të kalojnë kufirin që është në krah të fshatit për të shkruar në fshatrat e tyre në Shqipëri. Në qoftë se qëndron dikush në një nga monopetet e shumta që përdoren për kalimin nga njëri vend në tjetrin do të shikojë njerëz që vënë e vijnë me dendësi të madhe, disa për të shitur ndonjë prodhim ose të transportojnë për në vendin e tyre gjëra nga Greqia, të tjerë për të vizituar familjet e tyre, të tjerë për të shkruar në ndonjë dasmë a festë etj. Është karakteristike se fillon të vihet re se edhe tek emigrantët fenomeni i dy shtëpive, pasi, veçanërisht të gjithë ata që u rimëkembën ekonomikisht në Greqi, përpiqen që dhe këtu të kenë shtëpinë e tyre dhe në Shqipëri të rregullojnë shtëpinë e tyre. Në shumë raste është gjithashtu e mundur që disa thjesht të rrinë në Shqipëri dhe të punojnë në Greqi, përderisa fshatrat e tyre janë shumë afër kufirit dhe mund të lëvizin brenda ditës.

Vendosja dhe punësimi i shqiptarëve në rajonin e Konicës mund të bëhet e kuptueshme nën një dritë historike të marrëdhënieve ndërvendore në një rajon më të gjerë, i cili u nda me vendosjen e kufirit etnik dhe të shoqërive moderne dhe të dhënave demografike dhe ekonomike të rajonit. Karakteristika bazë e këtij rajoni është rrallimi demografik, plakja e popullsisë shpërbërja e boshtit shoqëror nëpër fshatra. Në thelb, vetëm në pellgun

---

[3] Në Molivdoskepasto funksionon një doganë e vogël që plotëson nevojat e njerezve të fshatrave fqinje. Le të vëmë në dukje se në çastin që shkruhen këto rreshta në Merxhan inagurohet një doganë e madhe e cila do t'i shërbëjë lidhjes së rajonit të Konicës me Shqipërinë dhe do të vë në lëvizje përsëri boshtin historik Konicë.



e Konicës dhe në disa fshatra malore blektorale dhe pyjore vihen re disa veprimtari prodhuese të rëndësishme. Një veprimtari e dendur ndërtuese shpjegohet aq sa tek termeti i vitit 1996 dhe ndihmat shtetërore me qëllim rindërtimin e rajonit, aq sa dhe tek tendenca e kthimit në fshat të njerëzve nga kjo zonë që banojnë në qytete dhe se një tendencë e dukshme e zhvillimit turistik në kuadrin e programeve kombëtaree dhe europiane.

Përgjithësisht në rajon ekziston një boshllëk demografik i madh, që shprehet dukshëm nga një popullsi e plakur dhe një riprodhim pa rrugëdalje. Disa studime që nga dhjetevjeçari i vitit 1950 kishin vënë re një «paradoks demografik» dmth fshatrat riprodhohen jashtë çdo caku dhe popullsia e plakur plotësohet nga firoja e saj natyrore nga bashkëfshatarët e mërgimit që kthehen pas daljes në pension në fshat periudhën<sup>4</sup>.

E fundit të mërgimit me fshatimn e origjinës së tyre bëhet me kalimin e kohës shumë herë me e rëndësishme veçanërisht qysh nga dhjetevjeçari i vitit 1980, gjatë të cilit paraqitet një tendencë masive kthimi i banoreve të qendrave urbane drejt fshatrave të origjinës së tyre me rezultat fenomenin e banesës së dytë që krijon premisa të fshatrave si vend pushimesh dhe të zhvillimit të disa veprimtarive turistike<sup>5</sup>. Këto zhvillime gjykohen të rëndësishme për kuptimin e ngjarjeve që krijohen në rajon me ardhjen e emigrantëve pas rënies së regjimit të Shqipërisë në vitin 1990.

Panja e përgjithshme e rajonit tek i cili vijnë për t'u integruar emigrantët shqiptarë paraqet karakteristikat e një zone malore të braktisur, me popullsi të plakur, me riprodhim në rënie, me një bosht shoqëror të shpërbërë, me peëjashtim të vetë Konicës, e cila përfshin dhe disa fshatra të tjera të shërbimeve, turiznit dhe tregtisë, disponon dhe fushën e saj me veprimtari bujqësore përreth fushës (Kalithea, Klidhonja, Mazi, Aetopetra dhe kryesisht Melisopetra). Për rajonin malor, nuk mund të bëhet fjalë për bujqësi, përveç kopshteve

---

[4] Shiko E. Mendras 1960, Hulumtini sociologjik i tri fshatrave malore dhe tre fushivë në rajonin e Konicës shtepia Epirote 8-9 (1959-60).

[5] Shiko: St. Dhamianakos-E. Zahopullu-X. Kasimis-B. Nicakos, 1997, «Pushtet, punë dhe kujdes në tri fshatra të Epirit», Dinamika Vendore e Mbijetesës, Plethron, Athina. Shiko: B. Nicakos, 1995, «Fshatra malorë të Pindit të Veriut. Në jehonën e një afati të gjatë», Plethron, Athina.



dhe disa arave të vogla për konsum familjar. Profesionet tradicionale të rajonit, këtu e disa dhjetëvjeçarë kanë humbur (mjeshtër të gurit, drugdhendës, ikonografë etj), ndërsa blektoria ushtrohet në një sipërfaqe të kufizuar si veprimtari e vendit dhe më shumë si e lëvizshme nga vllahët, kryesisht kalimtarë, blektorë që dimërojnë në fushat e Thesalisë, Maqedonisë dhe Thesprotisë. Nënvizojmë se para mbylljes së kufirit shqiptaro-grek shumë prej tyre dimëronin në livadhet dimërore të Shqipërisë si të Vlorës dhe Sarandës.

Kështu pjesa më e madhe e emigrantëve punon në sektorin e ndërtimeve, një pjesë në bujqësi kryesisht në fushën e Konicës një numër i konsiderueshëm në punë sezonale ndihmëse ose në punë të përditshme që lidhen me mirëmbajtjen e shtëpive, të kopshteve, të kujdesit për të moshmarit (pak gra) dhe sigurisht një numër i madh punon në blektori (kullotje dhe kujdes kopesh), një punë tani më e përçmuar nga shoqëria greke.

Përgjithësisht rajoni paraqet karakteristika të caktuara që krijojnë në një farë mënyre boshllëqe, të cilat vijnë e i plotësojnë emigrantët. Së pari ekziston një boshllëk demografik nga shkretimi i rajonit dhe një nevojë relative kujdesi për shtëpitë, mbështetjes dhe ndihmës së anëtarëve të popullsisë së plakur së dyti ekziston nevoja e fuqisë punëtore. Rindërtimi, mirë mbajtja e shtëpive dhe e kopshteve bëhet në kuadrin e interesit të emigrantëve, por dhe në lidhje me turizmin e të një veprimtarie ndërtimesh dhe të realizimit të veprave të zhvillimit bëhen nga ana e pushtetit vendor si ndërtime rrugësh, kalldremesh kanalesh të ujërave të zeza, rikonstruksione shtëpish etj.

Për sa u përket veprimitarive bujqësore ekzistojnë nevoja për fuqi punëtore për punë që nuk i bëjnë grekët si ngarkim shkarkim jonxhe, vaditje misri në fushën e Konicës, punë rastësore në lidhje me gjermime, pastrim arash e tj dhe në blektori për kullotjen e bagëtive dhe të tjera ndihmëse funksionale. Është karakteristike se në rajon i cili u specializua historikisht në artin e gurit, vitet e fundit mbetën pak mjeshtër dhe këta me moshë të avancuar dhe si rezultat prania e shqiptarëve, të cilët ose e njihnin profesionin ose e mësuan në praktikë, të plotësojë këtë nevojë që lidhet natyrisht me tendencën e përgjithshme «Kthim në origjinë» dhe realizimin të disa programeve të turizmit bujqësor dhe ekologjik të cilat kërkojnë ruajtjen dhe ringjalljen e traditave vendore.

Le të shohim se cilët janë këta emigrantë duke u nisur nga vendi i prejardhjes së tyre. Pjesa më e madhe e emigrantëve shqiptarë është nga rajonet fqinje të Leskovikut dhe



të Ersekës, bile është karakteristike afërsia gjeografike, me kuptimin se në bashkinë e Konicës gjenden emigrantë nga zona e Leskovikut, ndërsa në bashkinë e Mastorohoriave nga zona e Ersekës. Pjesa tjetër e emigrantëve kryesisht vijnë nga zonat e Përmetit, Tepelenës, Beratit, Korcës dhe pak nga Fieri. Vihet re një ndarje e punës me bazë vendin nga vijnë, pasi të ardhurit nga zonat fqinje punojnë kryesisht në sektorin e ndërtimit, gjë që lidhet sigurisht dhe me traditën e tyre (këto fshatra paraqesin historikisht një specializim teknik të njëjtë me atë të Mastorohoreve) ndërsa të tjerët punojnë në punë bujqësore dhe në të tjera, më shumë veprimtari rastësore dhe ndihmëse.

Emigrantët dallohen në definitivë dhe sezonalë. Përgjithësisht mund të themi se definitivët janë ata që punojnë në sektorin e ndërtimit, ndërsa sezonalët ata që merren me bujqësi. Në blektori paraqitet një gjendje e njëjtë, pasi kjo dallohet në blektori të lëvizshme dhe vendore dhe të gjithë ata merren me të si çobenj ndjekin ritmet e prodhimit, duke i ndjekur në rast të lëvizjes se kopeve në livadhet dimërore të Epirit, Thesalisë, dhe të Maqedonisë.

Etnikisht dallohen gjithashtu në ata që kanë origjinë greke të ashtuquajturit «Vorioepirotë» dhe një pjesë tjetër në shqiptarë edhe pse kriteret janë shumë të rrepta dhe në bisedime të vazhdueshme, pasi këto dy identitete pleksen dhe me një tjetër dallim atë të karakterit fetar që ka përmasa të dukshme etnike dhe kulturore (mes krishterëve dhe myslymanëve). Ekziston gjithashtu grupimi etnik i vllahëve që në terësinë e tyre janë të krishterë ortodoks dhe që kanë afërsi kulturore me vllahë brenda kufijve ku flasin të njëjtën gjuhë gjë që lehtëson takimet dhe bashkëpunimin midis tyre në masën kur ata nuk e flasin gjuhën greke.

Burrat emigrantë janë shumica, gratë diferencohen nëpër shtëpira, si pastruese ose në disa artizanate. Përsa i përket grave vihet re një numër i madh martesash me vendas ndërsa martesat analoge të burrave janë të pakta ky fenomen lidhet dhe me një boshllëk tjetër të shoqërive vendase. Konkretisht të «tregut» të kufizuar të grave falë përbuzjes së profesioneve bujqësore dhe dëshirës së përgjithshme për zonat urbane. Problemi i njohur i të rinjire të paktë që mbetën nëpër fshatra për të gjetur për t'u martuar duket se përballohet deri në një farë shkalle me «importimin» të grave nga Shqipëria.

Emigrantët mund të dallohen gjithashtu në të integruar dhe jo. Të parët i përkasin në vija



të përgjithshme kategorisë së familjarëve që janë vendosur me familjet e tyre dhe që vijnë nga zonat fqinje. Afërsia etnike, fetare dhe kulturore duket se përbën një element të rëndësishëm të integritit. Të dytët janë zakonisht sezonalë, të rinj, që punojnë në punë bujqësore dhe rastësore dhe vijnë sipas rregullit nga zona të largëta të Shqipërisë me karakteristika më të dukshme të ndryshimit etnik dhe kulturor.

Lëvizshmëria mes vendit të origjinës dhe vendit të punës është e dukshme, veçanërisht tek punëtorët sezonalë shumë prej tyre punojnë gjatë muajvë të verës, zakonisht nga muaji maj deri në nëntor ku qëndrojnë gjithë këtë periudhë në zonë, ndërsa muajt e dimrit qëndrojnë në vendin e tyre dhe kthehen vetëm kur ka punë rastësore ose kur kërkojnë ata. Afërsia gjeografike lehtëson mjaft këtë lëvizje. Theksojmë se shumë fshatra nuk janë më larg se 1 deri në 4 orë me këmbë nga kufiri apo nga fshatrat greke përkatëse.

Eshtë karakteristike gjithashtu fakti se në Konicë rreth fshatrave ekzistojnë sot shumë familje shqiptarësh që jetëjnë si gjithë pjesa tjetër e banorëve të zonës, ndërsa disa prej tyre kanë mundur të kenë dhe shtëpinë e tyre. Eshtë gjithashtu karakteristike se shumë emigrantë meremetojnë shtëpitë e tyre në vendin e tyre ose ndërtojnë të reja, ashtu siç shumë përpiqen të kultivojnë tokat e tyre që kanë aty pasi distancat lejojnë një lëvizje të shpeshtë. Duhet akoma theksuar se është vështirë të gjesh sot emigrantë të jetojnë në kushte të vështira siç rronin në vitet e para të ardhjes së tyre (në shtëpi të braktisura dhe magazina etj). Akoma edhe punëtorët sezonalë të fushës së Konicës kanë rregulluar banesat që jetojnë që të jenë kështu sa më njerëzore. Ndryshimi midis atyre që janë vendosur me familje në zonë dhe atyre që janë sezonalë është mjaft i dukshëm.

Përmirësim i kushteve të punës dhe i të ardhurave të tyre, në shumë prej tyre lejon që përveç përmirësimit dhe ndërtimit të banesave të reja në vendin e tyre dhe kujdesit ndaj pasurisë së atjeshme, të mbështetjes ekonomike të anëtarëve të famijes që mbeten atje ose me dërgimin e të hollave ose me dërgimin edhe të llojeve të ndryshme ushqimesh pasi vizitat reciproke janë të shpeshta. Ruajtja e lidhjeve familjare në vendin fqinj dikton tek emigrantët më kujdes të veçantë për prindërit që gjenden atje dhe për lidhja shpirtërore me vendin e origjinës-më tendencë për t'u kujdesur për shtëpinë dhe pasurinë e tyre. Ndryshimi i madh midis barazisë së lekut me dhrahmisë në vitet e para të emigrimit u dha mundësinë në shumë prej tyre të fillojnë akoma dhe investime në vendin e tyre me tendencë që pushoi për shkak të ngjarjeve të dhunshme të viteve 1996-1997. Ky vit



përbën një çarje dhe në drejtim të faktit se shumë u detyruan të sjëllin famijet e tyre ne Greqi për arsye sigurie. Një tjetër karakteristikë e pranisë së emigrantëve në rajon është se ka shumë rrugëkalime, me kuptimin se kryesisht pjesa veriore e këtij rajoni përdoret si kalim për në Maqedoninë Përendimore dhe në Thesali. Ky fenomen ishte më i shpeshtë në vitët e para, ndërsa tani paraqet pakësim falë pranisë së rojeve të kufirit dhe të mundësisë për të qenë të ligjshëm që u jep shteti grek dhe të zgjedhjes se një vendbanimi nga shumë emigrantë pas disa vitesh pune në vende të caktuara.

Do të ishte neglizhencë që të mos përmendnim akoma dhe praninë e shumë nxënësve që mikpritën në shumë konvikte të Konicës, kryesisht me kujdesin e Mitropolisë së Drinopoleos, Pogonianis dhe Konicës, fakt që parapet interes të veçantë drejt integritimit dhe asimilimit akoma dhe greqishtëzimin e shumë të rinjve me origjinë shqiptare. Të rëndësishme për mirëkuptimin e fenomenit të emigrimit në rajon janë strategjitë personale dhe familjare të emigrantëve. Shumica braktisin vendin në më fazë të parë në kuadrin e një eksodi masiv dhe pa shpresë falë të cilit është e pamundur të ketë një planifikim. Në këtë rregull përjashtim bëjnë emigrantet kryesisht ata me origjinë greke që erdhën në Greqi ligjshëm dhe me një pritje të veçantë.

Shumica dërmuese e njerëzve që u larguan për në Greqi pas rënies së regjimit shqiptar, janë të rinj në moshë ku sipas rregullit largohen pa marrë miratimin më parë të prindërve të tyre. Në vazhdim emigrimi i tyre futet në kuadrin e një strategjie familjare sipas funksionimit të ndërtimit të familjes nga gjiri i secilës të rinjtë largohen pas martesës së tyre. Është karakteristikë fakti që sipas rregullit të rinjtë emigrantë japin të hollat që grumbullojnë në llogarinë familjare që e mban babai dhe që janë pasuri e përbashkët që e administrojnë me bazë familjen duke marrë parasysh natyrisht nevojat, planet dhe perspektivat e secilit në veçanti. Për shembull shumica mundet të ndërtojë një shtëpi me kujdesin e babait, që të mundin kështu të vendosen në të pas martesës.

Përgjithësisht për sa i takon emigrantëve shqiptarë që nuk kanë origjinë greke nga çasti që kanë mundësinë të formojnë një strategji emigrimi dhe plane për të ardhmen duket si qëllim kanë kthimin në vendin e tyre me kusht se do të normalizohet situata politike, do të funksionojë rregullisht ekonomia dhe do të ketë mundësi punësimi. Këto plane nuk realizohen tani për tani për faktin se nuk duket të përmirësohen gjërat në vendin e tyre dhe klima për investime të mundëshme atje akoma nuk është pozitive. Pas



ngjarjeve të 1997 që provokuan ndjenja të fuqishme të pasigurisë dhe ësojnë një eksod të ri, duke i drejtuar paralelisht shumicën e tyre të humbasin depozitat e tyre për shkak të të njohurit «Skandal të Piramidave» disa përparojnë me frikë në investime të vogla në vendin e tyre të origjinës ndërsa të gjithë interesohen që të kenë aty të paktën një shtëpi, fakt që deklaron dhe dëshirën e tyre që një ditë të riatdhesohen. Duket me gjithë këtë, të paktën për ata që kanë familjet në Greqi, vendimet e tyre varen nga e ardhmja e fëmijëve të tyre. Me faktin e dhënë se fëmijët edukohen në shoqëri në një mjedis grek në një masë të madhe dhe nuk mësojnë gjuhën shqipe sistematikisht, dhe të mohimit të tyre të dukshëm për t'u larguar nga Greqia, prindërit është e vështirë të programojnë kthimin e tyre para se fëmijët e tyre të stabilizohen. Me bazë ç' ka më sipër u tha, mundet që të parashikojë ndokush se akoma dhe në rastin ku do të vendoset për riatdhesimin përfundimtar, ai do të realizohet nga fundi prodhimtarisë së fazës moshore. Elementi i afërsisë gjeografikë në rajonin e Konicës, zgjidh mjaft probleme për rezultojnë nga vetë largësia dhe të mungesës, pasi emigrantët mundet më lehtë të shkojnë në vendin e tyre dhe bile të kenë dhe aty një punësim sezonal. Shembujt e emigrantëve që kultivojnë disa toka në vendin e tyre, që kanë aty një kafene ose merren me tregti janë të shumtë, pa mundur që të gjitha këto të zbusin plotësisht mallin e të mërguarit dhe nostalgjinë për vendin e lindjes. Kjo nostalgji shprehet mjaft shpesh, bile krijon një mall në tregimet e tyre në lidhje me përçmimin e përgjithshëm që ndodh në vendin e tyre.

Në thelb, rënia e kufirit kombëtar më 1990 çoi në rivendosjen e një rrjeti komunikimi ndërvendor, të marrëdhënieve shoqërore dhe ekonomike e cila sugjeron një fushë për bashkon kufijtë kombëtarë dhe kritikon arbitraritetin dhe karakterin teknik të tyre. Rivendosja e kësaj fushe, edhe pse me mënyrë të dhunshme dhe jo normale ka çuar në një ribisedim aq sa të identiteteve kolektive pjesërisht të grupimeve etnike sa dhe të marrëdhënieve midis tyre dhe me qendrat kombëtare. Emërtimi «Vorioepirot» p.sh filloi të përdoret si vetëpërcaktues nga shqiptarët që vijnë nga Shqipëria e jugut, nga emërtimi gjeografik që grekët e karakterizojnë «Vorio Ipiro». Është karakteristik fakti se e pranojnë nacionalizmin grek, versionin e tij se ç' është «Vorio Epiri» që të inkuadrojnë vetën e tyre në kategorinë e vorioepirotëve dhe kështu të bëhen të pranueshëm në thelb si grekë. Kjo ndodh në një masë të madhe me ortodoksët shqiptarë por shpesh dhe myslymanë kujdesen që të marrin emra grekë ose akoma dhe të pagëzohen që të përfitojnë trajtim të mirë nga ana e shopërisë lokale por dhe të vetë shtetit grek.



Problemi i marrëdhënieve etnike dhe i indentiteteve është mjaft kompleks dhe nuk është në qëllimet e këtij shkrimi të preket. Do të mbetemi më shumë në rrjetin e marrëdhënieve që të shohim konkretisht cilën pamje paraqet kjo fushë shoqërore që është stabilizuar pas rënies së regjimit shqiptar dhe të rënies së kufirit. Fillimisht, duket se stabilizimi i kësaj fushe është në një shkallë të madhe e njëanëshme përse i përket lëvizjes së popullsisë, pasi popullsia shqiptare është ajo që kalon kufirin me çdo mënyrë. Përse i përket popullsisë greke është shumë e vogël interesimi për kalimin e kufirit, jashtë asaj që tregojnë persona që e kanë origjinën matanë kufirit, të cilët vizitojnë fshatra të origjinës së tyre për arsye emocionale dhe kuptohet me qëllim marrjen e pasurive. Mjaft familje nga Konica e kanë origjinën nga Leskoviku p.sh. kërkojnë pasuritë si dyqane dhe shtëpi ose pronësi të tjera. Diçka analoge ndodh dhe me disa shqiptarë ku stërgjyshërit e tyre e kishin origjinën nga Konica dhe që kishin pasuri aty. Arsye të tjera vizite të grekëve në Shqipëri janë kërkime për krahë të vjedhur, një problem që ka marrë përmasa të mëdha në vitet e para ose gjatë periudhës së trazirave (1996-97), tregtia e paligjshme, kërkësa për gra nga burra që vështirësohen të gjejnë bashkëshorte në zonën e tyre. Kjo e fundit sugjeron një aspekt të rëndësishëm të marrëdhënieve mes dy rajoneve në dy anët e kufirit të cilat në të kaluarën ishin marrëdhënie krushqie dhe të gjendjes demografike të zonës greke. Lëvizshmëria e njerëzve të rajonit të Konicës për në Shqipëri është e vogël, por nuk është e tillë lëvizja e të mirave materiale, dërgimi i të hollave, dhe të vetë shqiptarëve, ashtu siç është theksuar. Bile tregtia e vogël që ushtrohet në mes të dy rajoneve, është në duart e shqiptarëve, shumë nga të cilët duke u kthyer në atdheun e tyre nga vendi ku punojnë kujdesen që të marrin dhe disa të mira materiale të tregtueshme.

Duke iu rikthyer problemit tonë fillestar dhe për ta mbyllur mund të konkludojmë se në rastin konkret është fjala për formimin e një fushe shoqërore që i tejkalon kufijtë kombëtare dhe sugjeron në një shkallë të madhe rivendosjen e unitetit historik të rajonit dhe aktivizimin e rrugëve të komunikimit dhe të marrëdhënieve ekonomike, shoqërore dhe kulturore që zbatoheshin në të kaluarën midis familjeve, fshatrave dhe grupimeve etnike. Mund të bëjmë fjalë për një gjëndje emigracioni në të cilën, marrëdhëniet, veprimtaritë dhe mënyrat e jetësës përhapen midis dy shteteve etnike duke bashkuar kufijtë e tyre dhe duke krijuar një fushë të përbashkët midis dy shoqërive. Bëhet fjalë për një formë të fenomenit që shumë studiues të emigracionit e përcaktojnë si «transnationalism». Ky fenomen paraqet interes të veçantë dhe për problemin e identitetit të emigrantëve të cilët e jetojnë.



Pas mbledhjes së materialit u bë përpunimi i tij dhe u përcaktuan gjashtë tematika sipas brendisë së këngëve. Tematikat përcaktuan kuadrin brenda të cilit u bënë lëvizjet për aktivitetet e zgjedhura.

Në çdo tematikë aktivitetet zhvillohen në nivele. Niveli i parë u drejtohet nxënësve të klasës së parë dhe të dytë, niveli i dytë nxënësve të klasës së tretë dhe të katërt dhe niveli i tretë nxënësve të klasës së pestë dhe të gjashtë. Në fillim të çdo tematike theksohet qëllimi i përgjithshëm i realizimit të saj dhe synimet e veçanta që mund të arrihen nëpërmjet aktiviteteve. Në vazhdim përmenden këngët mbi të cilat u bazuan aktivitetet.

Përveç aktiviteteve që përmëndim në librin e nxënësit, ekzistojnë dhe aktivitete të tjera në librin e mësuesit. Aktivitetet janë kolektive dhe individuale. Numri i grupeve dhe numri i pjesëtarëve të çdo grupi varet nga numri i nxënësve të çdo klase. Gjithashtu, arsimtari mund të lëvizë dhe në aktivitete të niveleve të tjera, përveç atyre që i përkasin klasës së tij. Koha që do të kushtohet në çdo aktivitet por dhe veç në tematikën duhet të jetë përkatëse me interesat dhe mundësitë e nxënësve, por dhe me kohën që lënë detyrimet e tjera shkollore. Tematikat janë: «Teknika e tingujve», «Cikli i jetës», «Kafshët dhe natyra», «Uji na flet», «Profesionet tradicionale» dhe «Mërgimi».



Në fund do të bëhet vlerësimi i programit. Arsimtari gjatë zhvillimit të ngjarjeve do të kontrollojë nivelin e arritjes së synimeve që u vendosën dhe efektshmëria e veprimeve të tij. Lidhur me bashkëpunimin e nxënësve duhet të shënojë nëse punuan të gjithë nxënësit e çdo grupi, nëse u dëgjuan pikpamjet e të gjithëve dhe nëse u zgjdhën mosmarrëveshje që ndoshta u krijuan me dialog. Dhe së fundi, duhet të kontrollojë nga njëra anë sa u arrit synimi bazë i njohjes me kulturën popullore dhe bashkëpunimi me nxënësit nga ana tjetër e kufijve dhe nga ana tjetër nëse elementet e përbashkëta të dy krahinave që dolën brenda nga këngët popullore, përbënë element pasurimi dhe frymëzimi për krijimtari të mëtejshme dhe bashkëpunim.

## SIMBOLIZMI

Niveli 1:



Niveli 2:



Niveli 3:





## Arti i tingullit

---

Qëllimi kryesor i programit është të zhvillojnë qëndrim pozitiv dhe dashuri për muzikën dhe të vijjnë në kontakt me muzikën tradicionale

### **Synimet:**

- të dallojnë dhe të identifikojnë tablotë me tinguj nga mjedisi natyror.
- nëpërmjet muzikës dhe artit në pergjithësi t'u afrohen edhe objekteve të tjera të njohura, në kuadrin e kuadrit ndërtematik të afrimit të njohurive.
- të dëgjojnë me vetëpërqëndrim brenda nga procedurat e të dëgjuarit aktiv.
- të dallojnë këto veti bazë të tingullit dhe të muzikës, duke shtruar në to kuptimin e ritmit
- të zbulojnë se përbërja e elementeve të ndryshme të kulturave është dallimi kryesor i artit dhe nëpërmjet këtij konstatimi të pranojë diferencimin duke u afruar synimeve të arsimit ndërkulturor.
- të zhvillojnë në mënyrë krijuese elemente të imagjinimit të tyre dhe nga vendi i konsumatorit pasiv të muzikës të kalojnë në atë të krijuesit.
- të vlerësojnë artin si mjet bashkëekzistence.
- të dallojnë vetitë bazë të tingullit: nuancën, lartësinë, intensitetin, zgjatjen.
- të dallojnë ngjashmëritë që përshkojnë të dyja kulturat, por edhe elementet që i diferencojnë.
- të konstatojnë se muzika dhe arti në përgjithësi, është mënyrë shprehjeje të emocioneve dhe të mësojnë ta vlerësojnë që të shprehin dëshira të ndryshme të shpirtërore
- të ndajnë tingujt natyrorë nga tingujt artificialë.
- të vijjnë në kontakt me lloje të ndryshme të muzikës dhe të dallojnë karakteristikat kryesore të tyre.



- të bëjnë bashkëlidhjen që ka arti i muzikës me shkencën e matematikës
- të mësojnë të punojnë kolektivisht për arritjen e synimit të përbashkët.
- të mundin të ekzekutojnë forma të thjeshta ritmike e melodike
- t'i afrohen muzikës tradicionale dhe t'u afrohen elementeve të kulturës tradicionale brenda saj.
- të identifikojnë tingullin me burimin e prodhimit të tingullit
- të këndojnë individualisht dhe kolektivisht.

## Pretekst

Fëmijët u afrohen kuptimeve bazë të tingullit dhe te muzikës nëpërmjet këngëve tradicionale të Epirit dhe të Shqipërisë.

E.1.1.	«Nuk të pëlqeu Livadhja»	A.1.24.	«Në dritaret e mëdha»
E.1.5.	«Pesë trima»	A.7.2.	«Instrumentale»
E.1.9.	«Ju zogj fluturues»	A.7.3.	«Instrumentale»
E.2.7.	«Në këtë tavolinë që erdhëm»	A.7.8	«Instrumentale»
E.2.15.	«Ditën të mërkurën»	A.7.11.	«Instrumentale»
E.2.18.	«Nani-nani fëmijën»	A.7.12.	«Ç' gëzim, sa mirë»
E.5.6.	«Hyni vajza në valle»	A.7.16	«Instrumentale»
E.7.9.	«Drenushe»	A.7.17	«Instrumentale»
E.9.6.	«Plaku-Lingos»	A.8.2.	«Do të marr një këngë»
E.9.17.	«Zogjtë e mi të bardhë»	A.9.2.	«Prisje dru tek kodra»
E.11.2.	«Vaj»	A.13.11.	«Nani-nani fëmijën»
E.12.11.	«Mor limon i shkurtër»	A.13.20	«Vaj»



1

1. Kërkoni nga nxënësit të dëgjojnë pjesët e mëposhtme muzikore dhe të perpiqen t'i ndajnë në këngë, instrumentale, solo, ose polifonike. (A.16., A.8.2., A.7.17., A.9.2., A.7.3., E.7.3., E.1.1., E.1.5., E.5.6.):

	këngë	instrumentale
polifonike		
solo		

2. Le të vetëkrijojmë...

Nxënësit ftohen të mbledhin të gjitha instrumentet që kanë në klasë (vegla muzikore me perkusion, vegla që i krijuan vetë nxënësit). Ndahen në tri grupe:

Grupi i parë do të marrë përsipër recitimin e vjershës. Grupi i dytë do të zgjedhë një ose të shumtën dy nota, të cilat do të këndojnë gjatë gjithë kohës së recitimit. Grupi i tretë do të marrë përsipër të veshë recitimin me tinguj që mund të prodhojë nga instrumentet e klasës. Bëjnë prova çdo grup veç dhe bashkohen, kur çdo grup di të luajë shumë mirë rolin e vet në paraqitje.

3. Një shfaqje muzikoteatrale

Gjyshet dhe gjyshërit kanë mundësi magjike të thonë përralla të bukura: Nxënësit i ftojnë në klasë që të thonë një përrallë populloretë krahinës së tyre. Mbledhin përrallat që dëgjuan dhe zgjedhin një për ta paraqitur në një shfaqje që do të organizojnë me klasën e tyre në fund të vitit. Për paraqitjen do të ndahen në katër grupe.

Grupi A: Treguesit: janë nxënësit që do të marrin përsipër tregimin e përrallës që u zgjodh në klasë.

Grupi B: Aktorët: janë nxënësit që do të bëjnë disa role nga karakteret që ekzistojnë brenda në përrallë.

Grupi C: Muzikantët: janë nxënësit që do t'i japin shfaqjes muzikë, sidomos orën e tregimit ose dhe ndonjë moment tjetër që do ta gjykojnë të nevojshëm.



Grupi D: Skenografët-kostumjerët: janë nxënësit që do të marrin përsipër skenaret dhe kostumet e shfaqjes.

Do të ketë vështirësi, të gjeni ndonjë njeri që do t'ju tregojë përralla, mund të kërkonte përralla nga Antologjia juaj.

2

1. Shumë artistë janë frymëzuar nga muzika ose duke vizatuar vegla muzikore, këngë tarë ose partitura, ose duke bërë skulptura me temë veglat muzikore. Fëmijët ftohen të krijojnë një koleksion ne vepra të piktorëve ose të skulptorëve dhe të imitojnë shembullin e tyre duke krijuar të tyre me temë muzikën.

3

2. Mënyra e vetme për të mësuar brezi i ri këngën popullore, është transmetimi gojor nga brezi në brez. Çdo nxënës përbën hallkën e zinxhirit të traditës. Organizoni një festë për këngën popullore dhe në përgjithësi kulturën tradicionale në fund të vitit. Shembuj me propozime:

- Vlerësoni materialin që ju dhanë në kuadrin e këtij programi
- Ndani në grupe nxënësit me qëllim inçizimin e këngëve popullore nga të afërmit, nga miqtë dhe fqinjët që u takojnë brezave të mëparshëm nga ata.
- Ndajini në kategori, si ato të dasmës, ninullat etj.
- Organizoni kor, orkestër të vogël, me qëllim që të paraqitni këngët popullore.
- Bëni një ekspozitë me fotografi nga veglat tradicionale dhe veshje që u grumbulluan nga nxënësit.
- Paralelisht, përralla popullore të vendit paraqiten të dramatizuara ditën e festës.



## Cikli i jetë

---

Qëllimi kryesor i programit është të zbulojnë nxënësit e të dyja vendeve se arti përbën mjetin kryesor të emocioneve që burojnë nga stacionet më të mëdha në ciklin e jetës (lindja martesë, vdekja).

### **Synimet:**

- të kostatojnë se muzika dhe në përgjithësi arti, është mënyrë shprehjeje e emocioneve dhe të mësojnë ta vlerësojnë, për të shprehur dëshirat e ndryshme shpirtërore.
- t'i afrohen muzikës tradicionale të të dyja vendeve dhe brenda saj të njohin elementet e kulturës së tyre popullore.
- të vijjnë në kontakt me lloje të ndryshme të muzikës të dallojnë karakteristikat e tyre kryesore.
- të dallojnë ngjashmëritë që përshkrojnë të dyja kulturat.
- të zbulojnë se përbërja e të dhënave të kulturave të ndryshme është tipari kryesor i artit dhe brenda këtij konstatimi të pranojnë diferencimin duke afruar synimeve të edukimit ndërkulturor.
- të njohin zhvillimin historik të institucionit familjar të të dyja vendeve.
- të njohin zakonet dhe doket e krahinës së tyre dhe të krahinës në anën tjetër të kufijve.



## Pretekst

- |         |                            |             |  |
|---------|----------------------------|-------------|--|
| E.2.19. | «Nani nani fëmijën»        | A.1.2.      | «Dhimitraki i nënës»                   |
| E.5.2.  | «Lahet arhondi i vogël»    | A.1.13.     | «Tutje detit më mburrin një bukuroshe» |
| E.5.4.  | «Dil vjehërr tek shkalla»  | A.1.19.20.  | «Të premtën të shtunën në darkë»       |
| E.5.7.  | «Zaharulla»                | A.1.22.     | «Nani nani fëmijën»                    |
| E.6.4.  | «Biri i arhondit martohet» | A.1.23.     | «Më dhembti dhembti im»                |
| E.9.5.  | «Do të zbes tek Adhi»      | A.4.7.      | «Doli nusja tek shkalla»               |
| E.9.7.  | «Pini të pimë»             | A.5.4.      | «Kur vishet dhëndri»                   |
| E.9.10. | «Curliut»                  | A.5.5.      | «Lulet e botës»                        |
| E.11.2. | «Vaji»                     | A.5.10.     | «Rrugë të mbarë, o bijë»               |
| E.12.3. | «Dil, vjehërr tek porta»   | A.5.11.     | «Shkove për ujë apo jo»                |
| E.13.3. | «Nëna ime dhe nena jote»   | A.5.12.     | «Kunata jote nuse e re»                |
| E.13.8. | «Nani nani»                | A.5.14.     | «Erdhi të pa kunata»                   |
|         |                            | A.5.18.     | «Lule e manastirit»                    |
|         |                            | A.6.4.      | «Filxhani i rrumbullaktë»              |
|         |                            | A.6.12.     | «Trak-truk nëpër shkallë»              |
|         |                            | A.6.13.     | «Doli fshati dhe shikon»               |
|         |                            | A.6.14.     | «Kur kalon nëpër sokak»                |
|         |                            | A.7.2.      | «Instrumentale»                        |
|         |                            | A.7.8.      | «Instrumentale»                        |
|         |                            | A.7.12.     | «Ç' gëzim sa mirë»                     |
|         |                            | A.7.15.     | «Trëndafil me gjethe»                  |
|         |                            | A.8.8.      | «Mora shpejt rrugën»                   |
|         |                            | A.9.3.      | «Moj e bardhë si borë»                 |
|         |                            | A.9.9.      | «Kur merr sitën dhe gatuan»            |
|         |                            | A.10.9.     | «Krushqit»                             |
|         |                            | A.11.14.    | «U lodha moj nënë»                     |
|         |                            | A.13.11.    | «Nani nani»                            |
|         |                            | A.13.20.    | «O bir të lava dhe të ndërrova»        |
|         |                            | A.15.16.    | «Ku e ka shtëpinë krushku»             |
|         |                            | A.15.22-23. | «Shko, moj nënë i thuaj Janit»         |



**1** 1. Një ninullë e ndryshme. Kërkoni nga nxënësit të lexojnë vjershën e mëposhtme të Janit Ricos.

Ylli i mëngjesit  
Vashëza ime  
dua të të sjell  
fenerin e zambakëve  
të të driçojnë në gjumin tënd...  
cFli vashëz  
Rruga është e gjatë.  
Duhet të rritesh.  
Është e gjatë, e gjatë  
e gjatë rruga...

Ndani nxënësit në grupe:

### Grupi A

Duhet të lexojë vjershën disa herë, që të dijë ta lexojë drejt. Akoma më mirë, përpiquni ta mësoni përmendsh. Lexojeni qetë dhe me ton të ulët në zërin tuaj. Nëse grupi përbëhet nga shumë fëmijë, do të ishte mirë ta thoni të gjithë bashkë duke pëshpëritur.

### Grupi B

Nga veglat e klasës suaj zgjidhni ato që ju shkojnë më mirë për të shoqëruar me muzikë vjershën e Janit Ricu. Duhet të jenë veglat me zë të ulët dhe të luhen shumë qetë. Mund të përdorni ksilofonin dhe matalofonin, kambana të vogla dhe çdo gjë tjetër që shkon. Mos harroni kurrë tingujt që mund të përdorni me trupin tuaj! P.sh. përpiquni të imimtoni tingullin që bën era e qetë ose deti me gojën tuaj.

Bëni prova veças të dyja grupet dhe në vazhdim bashkë. Si dëgjohet?



2. Dëgjoni nga cd muzikore një natë të mirë të ëmbël të P. Kola, e cila përmban ninulla nga vende të ndryshme dhe kompozitorë. Udhëtimi fillon me një natë të mirë të ëmbël (Brahms) kalon pyjet, liqenet dhe shtigjet e Evropës dhe mbyllet –shumë mençur– duke u falur... dhe Endërra të ëmbla (P. Kola). Nxënësit thirren të ndjekin këtë udhëtim dhe me ngjyra,penelat dhe me imagjinatën e tyre të hedhur në letër.

1. «Një natë e mirë e ëmbël» (Brahms),
2. «Tek velat e anijes» (Slovakia),
3. «Nani» (Çeki),
4. «Këpucë të përgjumura» (Heino Gazel),
5. «Fenerët e natës» (Hollandë),
6. «Kafshët e pyllit» (Francë),
7. «Qengjat e qiellit» (Gjermani),
8. «Fli, ëngjelli im» (Çeki),
9. «Zogjtë e parajsës» (Rusi),
10. «Heshtat» (Austri / instrumentale),
11. «Pulëbardha» (Britani),
12. «Djepi» (Gjermani),
13. «Natën e mirë, ylli im» (Mozart),
14. «Hënë, drejtuesi im» (Schulz),
15. «Rozaku fle» (Filandë),
16. «Nani, fëmijën time» (Ukrani),
17. «Disa yje?» (Gjermani),
18. «Le të pushojë shiu» (Spanjë),
19. «Dhe ëndërra të ëmbla» (P. Kolas / instrumentale).

2

1. Me pretekst këngët «Biri i arhondit martohet» dhe «Janos dhe Marigo» u bënë dy përralla. Ide e mirë për shfaqje teatrale në fund të vitit. Për shfaqjen nxënësit do të ndahen në katër grupe:

Grupi A: Tregimtarët: janë fëmijët që do të marrin përsipër tregimin e përrallës që bëtë në klasë.



Grupi B: Aktorët: janë fëmijët që do të luajnë disa nga karakteret që ekzistojnë brenda në përrallë.

Grupi C: Muzikantët: janë fëmijët që do të marrin përsipër të investojnë shfaqjen me muzikë, sidomos gjatë orës së tregimit ose dhe ndonjë moment tjetër që gjykojnë të domosdoshëm.

Grupi D: Skenografët-Kostumjerët: janë fëmijët që do të marrin përsipër skenarët dhe kostumet e shfaqjes.

Shfaqja mund të mbyllet, duke kënduar të katër grupet bashkë këngën.

**2.** Familja me kalimin e viteve ndryshon formë. Familjarët e matriarkatit dhe patriarkatit. Familje të zgjedhura, bërthamore, dhe familje me një prind. Nxënësit në grupe përshkruajnë çdo formë. Gjejnë të dhëna për epokën që mbizotëron çdo formë, për zonën që shfaqen dhe arsyet për të cilat ndryshon formë familja. Nxënësit thirren të paraqesin në klasë familjen e tyre. Tregojnë tek bashkënxënësit fotografitë e pjesëtarëve të familjes së tyre, flasin dhe shkruajnë për prindërit e tyre, për vëllezërit e tyre, për vetën e tyre. Gjithashtu shënojnë pjesëtarë të familjes që jetojnë në vend tjetër. Kërkoni nga nxënësit të ndërtojnë drurin gjenealogjik të familjes së tyre dhe ta paraqesin në klasë duke mësuar gradën e farefisnisë.

**3**

**1.** Duke zgjedhur këngët nga ato që u regjistruan në kërkimin, por dhe informata të tjera të lidhura me traditat dhe zakonet e të dy krahinave që lidhen me atë, organizoni për verën shfaqje me temë «Cikli i jetës: lindja, martesja, vdekja në këngët greke dhe shqiptare». Shfaqja mund të programohet ditën që i kushtohet muzikës: më 21 Qershor, ditë Muzikore Evropiane.



## Kafshët dhe natyra

---

Qëllimi kryesor i programit është, me mjet muzikën tradicionale dhe sidomos këngët popullore, të dy vendeve që i referohen mjedisit (florës, dhe faunës por edhe atij materiali të çmuar që quhet ujë) t'i afrohen qëllimit kryesor të edukimit për njedisin që është sensibilizimi i brezit të ri për çeshtjet e mjedisit.

### **Synimet:**

- të vijnë në kontakt me muzikën tradicionale dhe nëpërmjet saj me kulturën tradicionale të dy po pujve.
- të mundin të bëjnë korrespondimin e tingullit me burimin prodhues.
- të vijnë në kontakt me veglat e orkestrës dhe veçanërisht me veglat tradicionale të dy zonave.
- të këndojnë kolektivisht dhe individualisht.
- t'i afrohen temës brenda nga mitologjia, nga letërsia nga muzika nga teatri dhe nga piktura.
- të kërkojnë të gjejnë nga burimet emërtimet, llojet e kafshëve që zbuluat se gjenden në të dyja zonat, shprehitë dhe mënyrat e jetesës dhe t'i ndajnë në grupe.
- të përshkruajnë mjedisin në të cilin jeton çdo kafshë të dy zonave.
- të informohen nga cilat rreziqe kërcenohen kafshët, cilat janë veprimet që prishin ekuilibrin e mjedisit (gjuetia, shfytëzëmi tregtar i llojeve të kafshëve, përdorini i keq i vendkalimeve natyrore) dhe nëse janë të përbashkëta ikosistemet e të dyja vendeve.
- të pyesin vetën për të «drejtat» e kafshëve dhe t'i mbrojnë.
- të përcaktojnë zinxhirin ushqimor dhe të konstatojnë se një ndryshim ose prishja e tij në një vend do të ketë pasojë në vendin fqinj.



- të njohin pasurinë e madhe të emocionere, të ideve, të njohurive që fshehin këngët popullore të dy vendeve.
- të mësojnë të ekzekutojnë forma të thjeshta muzikore dhe të shoqërojnë me vegla muzikore korin e tyre.
- të dallojnë disa nga llojet e muzikës si klasiken dhe tradicionalen.
- të dëgjojnë dhe të dallojnë veglat muzikore dhe të mundin t'i ndajnë në kategoritë e tyre sipas mënyrës që prodhojnë tingullin.
- të njohin kompozitorë të shquar dhe piktorë nëpërmjet veprave të tyre.
- zbulimi, përshkrimi dhe paraqitja e elementeve kryesore të mjedisit natyror të zonës nga të dyja anët e kufijve dhe sidomos të florës e të faunës nga nxënësit.

## Pretekst

E.1.2. «Nërerxë gjetheshumë»  
E.1.9. «Ju zogj fluturues»  
E.4.2. «Vreshti im fletëgjërë»  
E.4.5. «Kur niset shqiponja»  
E.7.9. «Drenushe»  
E.10.1. «U nisa rrugës rrugës»  
E.10.2. «Lule nga livadhi»  
E.10.11. «Bilbili i vogël»  
E.10.13. «Drenushe»  
E.12.2. «Një lemon gjetheshumë»  
E.12.11. «Limon i shkurtër»  
E.13.6. «Ku ishe, thëllezë e shkruar»  
E.13.7. «Lepuri»  
E.13.10. «Dil. Nënë, të shikosh diellin»  
E.14.1. «Unë vërbova diellin»

A.3.15. «Nerënxa ime ç'të thashë»  
A.12.22. «A më pranon në kopshtin tënd?»  
A.5.17. «Lule moj lolu»  
A.6.9. «Thëllëza mbi shkëmbinj»  
A.8.3. «Drenushe e gjatë belhollë»  
A.8.4. «Më pranon në kopshtin tënd»  
A.8.14. «Kur kalojë rrëzë malit»  
A.8.15. «Pse u rrite qysh tani»  
A.9.4. «U mbush oborri me pendë palloi»  
A.11.4. «Mbremë me dritën yjore»  
A.11.19. «Manushaqe»  
A.11.20. «Një ujël zonja Vangjelo»  
A.12.22. «Nërenxa ime ta thashë»  
A.14.8. «Kajsi e mbushur»



E.14.7. «Pesë rrape»

E.14.10. «Molla ime e kuqe»

A.14.11. «Po zbret thëllëza nga mali»

A.15.6. «A më pranon në kopshtin tënd,  
more kopshtar»

A.15.8–9. «Zura një thëllëzë»

A.15.13. «Këndojnë gjashtë bilbila»

## 1

1. Bëhet referim tek kafshët dhe në lëvizjen e tyre.

**Lojë:** Nxënësit bëjnë një lëvizje që i referohet një kafshëje. P.sh për elefantin ecin duke goditur fort këmbët e tyre në dysheme, për fluturën vrapojnë me duart lartë, për macen ecin këmbadoras pa bërë zhurmë dhe të tjera. Pasi janë dakort të gjithë për lëvizjet që do të bëjnë fillon loja. **Udhëzime:** Shpërndahuni brenda në klasë dhe ecni rregullisht, qetë dhe lirshëm. Sapo të dëgjoni veglën që i korrespondon një kafshe duhet të bëni lëvizjen përkatëse. Kush ngatërrohet del nga loja. Çdo herë që tingulli ndalon, vazhdojnë të ecin si në fillim. Fiton ai që mbetet i fundit.

2. E.13.8. «Lepuri», A.6.9. «Thëllëza mbi shkëmbinj».

Fabulat e Ezopit kanë rritur fëmijët në tërë botën. Lexojmë fabulën «Lepuri dhe breshka». Nxënësit sjellin në klasë ose tregojnë përralla që njohin dhe kanë për protagonistë kafshët.

3. E.10.11. «Bilbili i vogël», E.10.13. «Drenushe», A.15.13. «Këndojnë gjashtë bilbila». Ndiqni dokumentarë për kafshët.

4. E.10.11. «Bilbili i vogël», E.10.13. «Drenushe», E.12.3. «Dil, vjehërr, tek porta», E.13.7. «Kuishe, thëllëzë, e shkruar», E.13.8. «Lepuri».

Kaloni në ndërtim tabele me kategoritë e kafshëve (gjitarë, shpendë, zvaramikë, peshq) që gjenden në zonën e Epirit dhe në Shqipërinë Jugore. Nxënësit presin dhe ngjitin fotografi me kafshë dhe i vendosin në grupin përkatës.



**5.** E.7.9. «Drenushe», A.15.13. «Këndojnë gjashtë bilbila», E.13.8. «Lepuri».

Nxënësit ndërtojnë me alçi dhe baltë kafshë të Epirit dhe të Shqipërisë, kur thahen, i vizatojnë me bojëra të gjishtave dhe i vendosin mbi maketin me mjedisin natyror të dy zonave.

**6.** *Lojë teatrale:* Një kafshë cirku padit pronarin e cirkut për kushtet e të jetuarit të saj. Nxënësit marrin rolet, si kafshë, gjykatës, paditës i paditur, të betuar etj.

**7.** Loja do të përbëjë shkakun për bisedë dhe brenda nga loja fëmijët do të kuptojnë se gjuetari nuk mund të gjuajë në mënyrë të pakontrolluar, sepse kështu rrezikohet dhe vetë të zhduket, po të mbetet vetëm pa ushqim.

**8.** Grumbulloni të gjitha veglat që keni në klasën tuaj. Zgjidhni një përrallë me protagonistë kafshët. Për secilën nga kafshët që kanë rolin e protagonistit në përrallë, nxënësit zgjedhin dhe një nga veglat që kanë. Paraqesin përrallën, duke kombinuar muzikën me tregimin si tek përralla muzikore «Petros dhe ujku»

**9.** E.7.9. «Drenushe», E.10.11. «Bilbil i vogël», E.13.7. «Ku ishe, thëllezë shkruar», E.13.8. «Lepuri», A.6.9. «Thëllezja mbi shkëmbinj», A.8.3. «Drenushe e gjatë, belhollë».

Ndërtimi i librit me kafshët e dy krahinave. Çdo fëmijë do të marrë përsipër të projektojë një faqe që i referohet një kafshe. Në faqe do të ketë pikturë ose fotografi e kafshës, informata për shprehitë, për sjelljet e tyre dhe për rreziqet që e kërcenojnë.

**10.** *Propozojmë libra që duan natyrën!*

→ *Seri kafshësh që rrezikohen:* kareta, ariu i murmë, ujku. Kafshët simbol i natyrës së egër që kërcenohen me zhdukje dhe përrjekjet që bëhen për shpërtimin e tyre. Në bashkëpunim me organizatat për mjedisin «Arkuros», «Arhelon», «WWF Ellas» botime Erevnitis.

→ «Me biçikletën e erës» të Katerinës Anagnostu: histori me bula vese, me lulediel,



me urithë, bleta, që tregojnë peripecitë e tyre me udhërrëfyes biçikletën e erës, botime «Minoas».

- «Kafshë të Grëqisë» në rrezik të Eleni Fatsea. Një libër i vlefshëm, i shkruar me dashuri për kafshët, për zogjtë, peshqit dhe çdo gjë tjetër nga mbretëria e kafshëve rrezikon të zhduket, për arsye të trajtimit të keq të mjedisit nga njeriu, botime «Diaplasi».

## 2

1. Nxënësit ftohen të grumbullojnë fabula për kafshët dhe bimët e zonës së tyre. Fabulat shkruhen në kartela. Çdo kartelë do të ketë një fotografi ose një pikturë të lules në fabulën përkatëse. Kështu do të pasurohet koleksioni juaj me fabula dhe nxënësit do të shohin nëse ekzistojnë fabula të ngjashme ose të përbashkëta, por do të mësojnë dhe të reja.

2. *Foto-kuiz me bimë të dy zonave.*

**Udhëzime:** Prisni kartela prej kartoni 10x10. Në çdo kartelë vizatoni ose ngjitni fotografinë e një kafshe ose bime që rritet në të dyja anët e kufijve. Poshtë fotografisë shkruani tri përgjigje të mundshme. Ndani kartelat dhe gjeni përgjigjen a saktë nga të trijat. Fitues dhe natyralisht i shoqërisë është ai që mbledh më shumë kartela me përgjigje të sakta.

3. Ndjekim filmin «Fëmija dhe dhelpira» të biologut dhe regjizorit Lik Zake. Besuik në dashurinë e tij për natyrën, regjizori do të na udhëtojë në botën magjike të natyrës dhe do të na tregojë si vëzhgojnë mjedisin të dy protagonistët e filmit, vajza dhe dhelpira. Kur shikimi i vajzës dhe i dhelpres takohen, do të mundim të shohim dy pamje të ndryshme të së njëjtës botë!

4. Fëmijët ftojnë në klasën e tyre bashkënxënës dhe prindër në shfaqjen për njohjen e shijeve gjatë valimit e informacionit për bimët mjekësore të zonës së tyre. Çdo grup



përgatit lëngje për të pirë dhe të ftuarit mund të informohen për vetitë bamirëse të bimës mjekësore përkatëse dhe ta provojnë.

5. Për shfaqjen nxënësit do të përgatitin afishën dhe ftesat.

3

1. Nxënësit marrin pjesë në shfaqjen e fundit me këngë, valle, skeç teatral. Skeçin teatral mund ta shkruajnë vetë nxënësit. Si ide fillestare mund të dramatizojnë përralla klasike duke u dhënë një karakter «më ekologjik». Kushtu «kësulëkuqja» që shkon në pyll dhe shpëton ujkun që kërcenohet me zhdukje nga gjuetari e keq, «shtatë te vegjël» që shikojnë pyllin të marrë zjarr nga një pakujdesi e tyre, kurse nëna e tyre mungon. Me ndihmën e ujkut zjarrfikës vullnetar, lajmërojnë zjarrfiksin dhe shmangin fatalen. Meqënëse, imagjinata juaj, fëmijë, nuk ndalon atje, shkruani dhe ilustroni, nëse doni «përrallat tuaja klasike ekologjike». Mund t'i dërgoni në shkollë të vendit tjetër që bashkë punoni dhe kështu të lexoni dhe përrallat e tyre të frymëzuara nga tradita e tyre!

## 2. Paraqitja analitike e parqeve kombëtare.

([http://www.traveldailynews.gr/makeof.asp?central\\_id=1169&permanent\\_id=52](http://www.traveldailynews.gr/makeof.asp?central_id=1169&permanent_id=52))

→ Parku kombëtar – Olimbos

Bërthama e parkut kombëtar përfshin 44.500 dynymë ka lule të egra shumë të rralla:

→ Parku Kombëtar – Parnasos

Bërthama e parkut kombëtar Parnasos përfshin 36.000 dynymë. Pasuria e ornitofaunës është e madhe: huta, skifterë, shqiponja, lloje shqiponjash, qukapikë, thellëza mali.

→ Parku Kombëtar – Parnitha

Bërthama e saj përfshin 38.400 dynymë. Në Parnith janë numëruar 1.000 lloja



bimësh. p.sh. zambaku i kuq dhe peone e barthë. Disa prej tyre janë endemike të Attikës.

→ Parku Kombëtar – Eneu

Është parku më i vogël kombëtar në Greqi (22.400 dynymë) Flora e tij është e pasur në bimë endemire dhe në lloje bimësh të rralla.

→ Parku Kombëtar – Samaria

Bërthama e parkut kombëtar ka një sipërfaqe 51.000 dynymë. Në gremina jetojnë keca të egër, (kri – kri).

→ Parku Kombëtar i Iti

Bërthama e tij ka një sipërfaqe 14.000 dynymë. Na livadhe shumë të gjelbra, liqene alpine dhe lule të egra shumë të rralla.

→ Parku Kombëtar i Pindit (Valia kalota)

Bërthama (36.600 dynymë) përfshin pjesën më të madhe të luginës e Valia Kalda. Karakteristikë e bimësisë së parkut janë pyjet me pisha të zeza, pyje ahesh. Mbijnë gjithashtu pak pisha të kuqe, dushkqe, panja, kurse bimësia pranë lumenjve një përbëhet nga rrepet, shelgjet, etj. Këtu banojnë arinj të Pindit.

→ Parku Kombëtar i Vikos–Vjosë

Bërthama, ka sipërfaqe 34.120 dynymë. Përfshin grykën e ngushtë e të thallë të Bikos dhe terrem. Këtu është shumë i ashpër që të preth frymën. Yeçanërisht e pasur është bimësia e parkut, numërohen pothuaj 50 lloje të pemëve pyjore (pisha të zeza, bredha të Maqedonossë, thana, librët, dushke, panja, alie etj.). Në zonat pranë lumenjve mbijnë rrape, shelgje, kurse në zonat me lartësi të madhe mbi nivelin e detit, mbijnë bimët e shkurta që rezistojnë borës. Flora përbëhet nga bimë shumë të rralla endemike si gështenja e hidhur. Në parkun kombëtar të Vikos jetojnë pak arinj, dera të egër, ujq, zorkadhe, dhi të egra dhe maçokë të egër, në lumenj jetojnë 7 lloje peshqish (trofta, cirone, gjitari vidër, 15 lloje amfibesh dhe zvaranikësh πρoνύφeς dhe insekte uji. Në ornithofaunën e zonës janë pothuaj 110 lloje zogjsh, si shqiponja, skifterë, lloje shqiponjash, petrita, shqiponja që hanë gjarpërinj, mëllënja uji, trishtila, etj.



- Parku Kombëtar i Sunios  
Bërthama është vetëm 5.250 dynymë. I mbushur me miniera të lashta, sodit Egeon.
- Parku Kombëtar i Prespës  
Ndodhet në anën veriperëndimore të Greqisë dhe i takon prefekturës së Florinës. Përbën kufirin natyror midis Greqisë, ish Jugosllavisë dhe Shqipërisë. Bërthama ka sipërfaqe 45.120 dynymë. Përbën njërin nga 11 vendet greke të biojetësës ujore me rëndësi ndërkombëtare sipas marrëveshjes që u nënshkrua në qytetin Ramsar të Iranit më 1971. Në të dyja liqenet e bukura gjenden pelikanë dhe zogj të tjerë të rrallë.

## **Paraqitje anatike e parqeve kombëtare shqiptare.**

- Parku kombëtar i Dajtit  
Ndodhet në pjesën lindore të kryeqytetit dhe ka sipërfaqe 3.300 ha. Atje gjenden ahe 200 vjenare që përbëjnë monumente natyrore.
- Parku kombëtar i Thethit  
Ka sipërfaqe 2630 ha dhe ndodhet afër qytetit të Shkodrës. Përshkohet nga lumi Thethi dhe gjendet ujëvara e Grunasit. Këtu rritet lisi.
- Parku kombëtar i Lurës  
Sipërfaqja e tij është 1280 ha. 14 liqenet e Lurës që ndodhen në park në dimër ngrijnë sipërfaqet. Këtu takon ndokush pemë shekullore halore.
- Parku kombëtar i Logarasë  
Këtu ndodhet «pisha flamur» e cila përbën një monument të rrallë natyror.
- Parku kombëtar i Butrintit  
Ndodhet në jug të qytetit të Sarandës. Sipërfaqja e tij është 2500 ha.
- Parku kombëtar i Prespës  
Ka sipërfaqe 27750 ha dhe në kryq-zim të kufijve Greqi-Shqipëri dhe ish



Republikës Juosllave të Maqedonisë. Liqenet e Prespës janë përfshirë në parkun ballkanik me marrëveshje të përbashkët të tri vendeve.

**3. E.4.5. «Kur niset shqiponja», A.15.8-9. «Zura një thëllëzë».**

Nxënësit nxitën të vizatojnë faqen e internetit të qendrës greke për shërimin e kafsheve të egra, të lajmërohen dhe të kalojnë në veprim simbolik të adoptimit.

**4.** Nxënësit mund të vizitojnë qendrën e informimit për ariun e murmë tek Shqiponja e Florinës dhe në vazhdim tek strofka e saj në Nimfeo, për ta njohur nga afër. Nëse nuk është e lehtë, vizitoni vendin e organizatës në internet.

**5. Lojë ekologjike**

Cdo fëmijë merr një rol në lojë. Do të jetë një bimë ose një kafshë dhe do të mësojë pak fjalë për kafshën ose bimën që do të luajë në lojë, por edhe për rreziqet që e kërcënojnë. Fëmijët janë në një rreth. Lojtari i parë mban në dorën e tij një lëmsh peri, thotë pjesën dhe duke mbajtur njërin anë të perit hedh lëmshin tek lojtari tjetër duke shpjeguar arsyen që e zgjedh (p.sh jam dhelpër, gjitari më i zgjuar dhe më gjen në fabulat e Ezopit dhe ekzistojnë shumë fjalë të urta për mua. Folenë time e ndërtoj brenda në shkëmbinj dhe lind 3 me 5 të vegjël. Një nga mezet e mia të dashura është lepuri dhe i hedh lëmshin. Atëherë dhe ai paraqet rolin e tij në natyrë, dhe mbështjell perin në dorën e tij dhe hedh lëmshin tek lojtari tjetër. Kjo gjë vazhdon deri sa nxënësit të marrin lëmshin dhe të flasin. Kështu janë të lidhura dhe të varura të gjitha kafshët dhe bimët e natyrës. Zinxhiri thyhet kur lojtari i fundit thotë për n'arsye duhet të ikë nga pylli ose pse është zhdukur nga natyra (gjuetia, zjarri) dhe lë perin dhe ikën. Të njëjtën gjë bëjnë dhe lojtarët e tjerë dhe kështu thyhet zinxhiri i natyrës. Diskutoni në klasë për arsyet që u thye zinxhiri (ekuilibri ekologjik).



## Uji na fletë

---

Në skenari, me pretekst lumin Vjosa që përshkon Greqinë dhe Shqipërinë, synojmë të kuptojnë nxënësit elementet e përbashkëta kulturore që bashkojnë të dyja vendet fqinje dhe të kuptojnë qellimin bazë të edukimit për mjedisin që është nevoja e sesibilizimit të brezit të ri përballë çështjeve të mjedisit.

### **Synimet:**

- të vijnë në kontakt me muzikën tradicionale dhe nëpërmjet tyre me kulturën e dy popujve
- zbullimi, përshkrimi dhe paraqitja e elementeve nga nxënësit të mjedisit natyror nga të dyja anët e kufijve dhe sidomos të florës e të faunës.
- t'i afrohen temës brenda nga mitologjia, nga letërsia, nga muzika dhe nga piktura.
- të njohin pasurinë e madhe të ideve, emocioneve dhe e njohurive që fshehin këngët popullore të dy zonave.
- të kuptojnë ciklin e ujit.
- të sensibilizohen për vlerat që ka uji, për të jetuar në planetin tonë.
- të njohin rolin e ujit në zhvillimi e kultarave.
- të kërkojnë zgjidhje për përdorimin e saktë dhe konsumimin e ujit.



## Pretekst

- A.5.11. «Shkove për ujë apo jo»
- A.11.5. «Burimi i Gusharës»
- A.11.7.5. «Hajde, Maro, tek burimi»
- A.11.20. «Një ujë, zonja–Vangjelo»
- E.13.6. «O zot, hidh një shi»

**1**

### 1. Le të krijojmë vegla...

Ekzistojnë shumë mënyra për të prodhuar tingullin e ujit. Një prej tyre është ndërtimi i veglës muzikore që quhet rain stick, ose ndryshe «uji i shiut».

**2**

Fillimisht duhet tuba cilinrikë. Mund të përdoret tup letre, letër alumini ose kuzhine, letër higjenike, tub letre që përdorin në librari për të vënë brenda kartona ose afisha ose çdo gjë tjetër që mund të imagjini. Mbyllni tubin nga njerën anë me një karton dhe shirit ngjitës. Në vazhdim mbushni rreth  $\frac{1}{3}$  tubin tuaj me një nga materialet e mëposhtëm: oriz, thjerrëza, fasole në madhësi të ndryshme, grur ose drithëra të tjera edhe diçka tjetër të ngjashëm që mund të imagjini. Të mbani mend se sa më i madh mund të jetë diametri dhe gjatësia e tubit kaq më i madh duhet të jetë materiali me të cilin do ta mbushni.

**3**

Në vazhdim mbillni dhe anën tjetër të tubit. Ktheni përmbys tubin shumë ngadalë, që materiali i mbushjes të shkojë nga një anë në tjetrën. Tingulli që prodhohet ngjan kaq më ujin e shiut si dhe me tingullin që bën vala e detit në bregdet.

Zbukuroni tubin tuaj duke e vizatuar, zbukurojeni me kordele ose penj ose me diçka tjetër doni. Mund të ndërtoni shumë lloje të ndryshme sipas gjatësisë, diametrit të tubit dhe me materialet e ndryshme të mbushjes.



**2. Duke vlerësuar ujin dhe vegla të tjera muzikore.**

Marrin nga farmacia 8 tuba qelqi të mbyllur nga njerën anë të tubit me diametër 10mm. I mbushim me ujë të ngjyrosur. Ku niveli i të cilit të jetë si më poshtë:  
A=30cm, B=30cm, C=27cm, Ç=25cm, D=23cm, Dh=20cm, E=17cm.

Godasim tubat me një send metalik (P.sh. bastuni metalik nga trekëndshi që themi kolendrat Vitin e Ri) dhe vëzhgojmë tingujt. Me të njëjtën mënyrë mund të mbushni me ujë shishe qelqi me nivele të ndyshme çdo njeri. Në vazhdim fryni lehtë grykën e shishes dhe vëzhgoni tingujt që prodhohen.

**3.** Duke vlerësuar organet që ndërtuan në klasë nxënësit mund t'i krijojnë vetë tingujt dhe të krijojnë muzikën e tyre. Zakonisht muzika që prodhohet më këte mënyrë përbën muzikën e shkëlqyer me shoqërim për recitim vjershje ose për tregimi e ndonjë historie. Në fund zgjedhin një nga fabulat që kanë lexuar dhe e tregojnë ne klasë me shoqërimin e veglave muzikore të tyre.

**4.** Kërkojmë nga nxënësit të gjëjnë informata për kulturat që u zhvilluan pranë lumenjve. Dhe të shtojnë në tabelë edhe shembuj të tjerë.

<u>Lumi</u>	<u>Kultura</u>
<u>Nili</u>	<u>Egjipt</u>
<u>Tigër-Eufrat</u>	<u>Popuj të Mesopotamisë</u>

Shtrohen pyetje-punime, si:

- Pse besoni se u zhvilluan këto kultura afër lumenjve?
- Ku mund të ndihmojë uji në zhvillimin e një kulture?
- Ndahuni në grup, çdo grup do të marrë përsipër të paraqesë në klasë njërën nga kulturat.



5. Vjosa shpesh në të kaluarën përbënte pengesë në lëvizjet e njerëzve. Si e tejkaluan njerëzit? Orgazinozi një fushatë fotografike me ura tradicionale. Njëkohësisht nxënësit përpunon të mbledhin informata për këto dhe plotësoni fletën e regjistrimit të elementeve.

lum: .....

vendi: .....

emri i urës: .....

lartësia e urës: .....

gjerësia e urës: .....

numri i harqeve: .....

materialet e ndërtimit: .....

informata për ndërtimin: .....

histori dhe fabula të urës: .....

informata të tjera: .....

**6. 22 marsi: «Dita Ndërkombëtare e Ujit».**

Krijoni një ekzpozitë për ujin që të tregojë se artistët u frymëzuan nga uji. Mund të përfshijë fotografi, kopje pikturash, karta, pjesë letrare dhe sigurisht krijimet personale të nxënësve tuaj.



## Profesionet tradicionale

---

Qëllimi kryesor i programit është të zbulojnë nxënësit zhvillimin e përbashkët kulturor të banorëve të zonave fqinje në Greqi dhe në Shqipëri, në lidhje me format, mënyrën dhe mjetet e punës.

### **Synimet:**

- brenda nga aktivitetet e të dëgjuarit aktiv të këngëve popullore greke dhe shqiptare, të veçojnë muzikën instrumentale nga muzika vokale dhe korin nga soloja.
- të identifikojnë tingullin me burimin prodhues.
- të identifikojnë figurat me tingujt e mjedisit fshatar dhe qytetar të punës.
- të njohin vende që i referohen kulturës në të dyja vendet (muze folklorike, punishte tradicionale).
- të konstatojnë lidhjet e artit me përditshmërinë e njerëzve në të dyja zonat.
- të dëgjojnë përalla e histori, fjalë të urta, citate që ekzistojnë në traditën e dy popujve.
- të njohin njedisin historik, kulturor dhe natyrën e shtëpive tradicionale të zonës së tyre dhe të zbulojnë elemente të përbashkëta dhe ndryshmet që mund të ekzistojnë në palën përballë.
- pasurimi i njohurive të nxënësve për trashëgiminë e përbashkët kulturore dhe nga vetëveprimi të njohin biomat personale.
- mirëkuptimi, respekti dhe çmuarja e trashëgimisë kulturore të çdo vendi.
- njohja me veshjet e ndryshme tradicionale të dy popujve.
- përforcimi i lidhjeve të bashkëpunimit dhe solidaritetit midis bashkënxënësve të shkollës si dhe të nxënësve të dy popujve.
- të dëgjuarit dhe të mësuarit e këngëve tradicionale greke dhe shqipe.
- të mësuarit e valleve tradicionale greke dhe shqiptare.



- mikpritja e profesionistëve, gjyshërve dhe gjysheve për të paraqitur profesione tradicionale që janë të përbashkëta në të dyja zonat.
- të njohin karakteristikat bazë të tingulit, nuancën intensitetin, zgjatjen, ritmin dhe melodinë.
- të vijjnë në kontakt me format muzikore, si koncerti.
- të këndojnë dhe të kërcëjnë këngë tradicionale të dy krahinave.
- njohja me motive tradicionale të qendisjeve dhe të endjeve të dy zonave.
- mikpritja në shkallë të këngëtarëve tradicional dhe të pranojnë elementet e përbashkëta.
- njohja me veglat muzikore të përbashkëta grumbullim informatash për origjinën e tyre, për mënyrën e ndërtimit dhe në përgjithësi, për karakteristikat e veçanta.
- njohja me veprën e piktorëve (piktura tradicionale por dhe moderne).
- të ndertojnë vegla muzikore të improvizuara, duke vlerësuar njohuritë e tyre nga mësimi i gzikës.
- të ushtruarit e nxënësve në mënyrën kolektive të punës, të grumbullimit dhe përpunimit të të dhënave në lidhje me temë konkrete.
- të njohin mënyrën e thjeshtë të jetës të njerëzve që jetuan para zhvillimit industrial në të dyja zonat.
- të njohin tekste të letërsisë femnore dhe popullore të dy vendve.
- të njohin nxënësit materialet e ndërtimit, si punonin muratorët dhe të bëjnë krahasimin e arkitekturës së me arkitekturën e re në të dy vendet.

## Pretekst

- E.1.8. «Dimër i mallkuar»
- E.4.2. «Vreshti im fletëgjërë»
- E.4.3. «Në fushën Sirjote»
- E.9.1. «Unë isha arkondi i vogël»
- E.9.4. «Të kisha një postier»
- E.10.16. «Ura e Artës»



- A.1.4. «Qan Bucina, qan koko ri»
- A.1.6. «Kërraba jote e qëndisur»
- A.1.16. «Gjithën ditën me dhitë»
- A.1.21. «Kur dalin plakat tek lëmët»
- A.3.3. «Lajmin sjell lajmëtari»
- A.5.6 «U zgjova herët në mëgjës dhe shkova tek burimi»
- A.5.11. «Shkova për ujë apo jo»
- A.6.6. «Shkova tek mulliri»
- A.7.13. «Në Leskovik fryu një erë»
- A.8.9. «Një çoban lart në mal»
- A.11.2 «Një çobaneshë e bukur kaloi mali»
- A.11.11. «Shkoj tek vreshti»
- A.11.20. «Një ujë zonia Vangjelo»
- A.11.22. «Karaguna»
- A.12.2. «Aman, mullixhi more mullixhi»
- A.12.13. «Larg dedit»
- A.14.10. «Çobaneshë, moj çobaneshë»
- A.15.20. «Urë e zezë, moj urë e zezë»

## 1

1. Kënga bëhet shkak për të folur për ato forma të artit tradicional që lulëzuan në të dyja zonat. (Propozohet vizita në një punishte argjendarie dhe drushkalitje etj.).

2. Kacalidhas, Gr, «Një bijë, një bijë nga Leshnica», Këngë popullore nga V. Epiri, f. 525.  
Kacalidhas, Gr, «Karaguna shkon tek burimi», Këngë popullore nga V. Epiri, f.528  
A.11.22. «Karaguna»

Të vizitoni një muze folklorik dhe të shikoni veshjet tradicionale. Nxënësit krahasojnë dhe komendojnë veshjet. Në vazhdim sjellin fotografi dhe informata për veshjet e zonës tjetër dhe bëjnë vërejtjet e tyre.



3. Me punimet e nxënësve bëhet një kend me objekte balte. Temat merren nga objektet e përdorimit të përdishëm të dy zonave.

4. nxënësit nxiten të mësojnë të këndojnë dhe të kërcëjnë valle që u referohen profesioneve. Do t'i paraqesin në shfaqjen bashkë me klasat e tjera. Mundin, gjithashtu, të paraqesin me grupime këngët «Kështjella e Rozafatit» dhe E.10.16. «Ura e Artës».

## 2

1. Kacalidhas, Gr, «Një bijë, një bijë nga Leshnica», Këngë popullore nga V. Epiri, f. 525.  
Kacalidhas, Gr, «Karaguna shkon tek burimi», Këngë popullore nga V. Epiri, f.528  
A.11.22. «Karaguna»

Të vizitoni një muze folklorik dhe të shikoni veshjet tradicionale. Nxënësit krahasojnë dhe kometentojnë veshjet. Në vazhdim sjellin fotografi dhe informata për veshjet e zonës tjetër dhe bëjnë vërejtjet.

2. Me punimet e nxënësve krijohet një kend me objekte balte. Temat thithen nga objektet e përdorimit të përnditshëm.

3. E.10.16. «Ura e Artës». Nxënësit ndahen në pesë grupe dhe çdo grup merr përsipër të regjistrojë me aparat fotografik një kategori muresh tradicionale prej guri. Fotografitë do të përbejnë materialin për ekzpozitë fotografike të nxënësve. Në bashkepunim me ndonjë shkollë të vendit tjetër këmbëjnë material fotografik dhe pasurojnë ekzpozitën e tyre.

4. Është e mirë të krijoni muzeun tuaj folklorik në territorin e shkollës suaj me sendet e ekzpozuar nga profesionet e së kaluarës. Mund të ekzpozoni vegla që përdornin mjeshtërit, bujqit dhe blektorët në të kaluarën, fotografi të vjetra, vepra të mjeshtërve



(drugdhendjet, argjendurinat, enë balte, qendisjet, endjet etj). dhe çdo gjë tjetër ekziston në do llapet e shtepive tuaj. Mos harroni:

- Të regjistroni sendet e ekspozuara dhe kush ka dhënë në grumbullim.
- Të ftoni nxënës nga shkollat e tjera të vizitojnë muzeun.
- Të ftoni prindër dhe miq të nxënësve të shikojnë në koleksion
- T'i informoni vizitorët për ekspozimet
- Të ekzistojnë një libër me përshitje ku vizitorët të shkrujnë përshtypjet e tyre
- Të ekzistojnë në muzikë, këngët që do të dëgjohen do t' u referohen profesioneve
- Në fund t'u ktheni sendet e ekspozuara njëerëzve që i dhanë, bashkë me një kartë falenderimi që do të krijoni vetë.

5. Për shfaqjen në fund të programit për një profesion duke kënduar e kërcyer një këngë lidhur me të: Greqisht dhe Shqip për këngë dhe valle: E.4.2. «Vreshti im fletëgjërë», «Isha unë arkondi i vogel», «Të kisha një postier», A.11.20. «Një ujë zonja Vangjelo», «Një çoban lart në mal».

3

1. Kënga bëhet shkak për të folur për ato forma të artit tradicional që lulezuan në të dyja vendet. Propozohet vizita në një punishte argjendarie, drugdhendjeje etj. Me qëllim të rergjistrojnë nxënësit të dhëna për profesionin si vegla, teknikë dhe personeli njerëzor. Para vizitës do të hartoni me nxënësit një fletëankete ku pyetjet do të jenë të formës:

- Sa vjet bëni këtë punë?
- Kush ju mësoi profesionin tuaj?
- Është e lodhshme dhe këmbëngulëse puna?

2. Ndahen nxënësit në tri grupe. Çdo njëri do të marrë përsipër të ndërtojë një vegël muzikore sipas udhëzimeve që jepen.



- Grupi A: presim 8 tuba alumini ose material tjetër me diametër 10 mm. Gjatësia e tubave të jetë si më poshtë:  
A=33 cm, B=30 cm, C=27 cm, D=25 cm, Dh=23 cm, E=20 cm, F= 17 cm.  
Tubat i stabilizojmë në dërrasë të cilës i kemi vënë dy lastikë ose shkumë deti, godasim tubat me një send druri dhe vëzhgojmë tingujt.
- Grupi B: e një dërrasë stabilizojmë 8 tela të tendosura mirë. Gjatësia e çdo teli është pothuaj si më poshtë:  
A=53cm, B=30cm, C=25cm, Dh=23cm, E=20cm, F=17cm. Më dorën tonë tërheqim kordat dhe vëzhgojmë tingujt.
- Grupi C: Marrim nga farmacia 8 tuba qelqi të mbyllur nga njërën anë me diametër 10mm. I mbushim me ujë të ngjyrosur me nivel tek çdo njëri, si më poshtë:  
A=33cm, B=30cm, C=25cm, D=23cm, Dh=23cm, E=17 cm, godasim tubat me një send metalik (p.sh me pjesën metalike nga trekëndshi kur themi kolendrat për vitin e ri) dhe vëzhgojmë tingujt.

3. Kacalidhas, Gr, «Një bijë, një bijë nga Leshnica», Këngë popullore nga V. Epiri, f. 525.  
Kacalidhas, Gr, «Karaguna shkon tek burimi», Këngë popullore nga V. Epiri, f.528  
A.11.22. «Karaguna»

Të vizitoni një muze folklorik dhe të shikoni veshjet tradicionale. Në vazhdim sjellin fotografi dhe informata për veshjet e zonës tjetër dhe bëjnë vërejtjet e tyre.

4. Endja u zhvillua tek të dyja zonat dhe ka për të paraqitur shumë gjëra të artit të endjes sigurisht tek dollopët ose baulet e shtëpive ose të shtëpive mike ekzistojnë qilima të bëra me dorë. Me një aparat fotografik nxënësit i fotografojnë, shënojnë pronarin e qilimit, punuesin, por edhe vitin që u punua. Fotografitë i paraqesin në shfaqjen. Kështu dotë ndihmojnë të mos humbin këto kryervepra. Mund, gjithashtu të kërkojnë informata nga gjyshet që dinë të endin, t'u flasin për endjen dhe të këndojnë këngë te zgjahu.



5. Pervec këngëve tradicionale që u referohen profesioneve tradicionale, ekzistojnë dhe këngë moderne për profesioneti. Nxënësit këngojnë të gjejnë disa këngë të tilla dhe i sjellin t'i dëgjojnë në klasë. Si shembull përmendet cd muzikore me titull «Profesionet në këngën rebate, inçizime 1932-1949» i cili përkubar këngët e mëposhtme:

Tip: CD muzikore  
Kategoria: këngë rebete dhe këngë të vjetra  
Kërkues : Të ndryshëm  
Shoqata: MUSIC BOX  
Qarkullim: 27/09/2005  
Numri i disqeve: 1

N/R	Titull
1	Punëtori – Kostas Rukunas
2	Kaldaisti – Jorgos Batis
3	Tagrambledhësi – Rita Abaxi
4	Markos Politekniku – Markos Vamvakaris dhe Sofia Karivali
5	Shitësi i perimeve – D. Gogos dhe J. Sajias
6	Rrobaqepsja – Od. Moshonjas dhe Sot. Bellu
7	Shitësi i perimeve: R. Episkenazi
8	Jam mjeshtër i dëgjuar – Jorgos Kavuras
9	Peshkuesit – Jorgos Batis
10	Shoferët – Str. Pajiumxi
11	Bërësi i kokoshëve – Ioanna Jeorgakopulu
12	Peshkatari – Str. Pajumxi
13	Kamarieri – R. Eskenazi
14	Fotografët – J. Batis
15	Detari – Str. Pajiumxi dhe St. Perpiniadis
16	Kasapi – Markos Vamvakaris
17	Berberi – Jorgos Batis
18	Hasapi – Kostas Nuros
19	Kaldaisti – Dimitris Rumeliotis
20	Këpucari – R. Abaxi



**6.** Vizita në muze gjykohet e domosdoshme, që të mundin nxënësit të merren me aktivitete të tematikës. Nëse vizita nuk është e mundshme nxënësit do të kërkojnë informata tek interneti dhe në bibliotekat.

**7.** Nxënësit të ndarë në grupe marrin përsipër të kërkojnë informata për grupet tematike, të mëposhtme.

→ A Muratorët: origina, udhëtimet, profesione të ndryshme tradicionale, organizatatë esnafësh vegla, dialekt, tradita, zakone, këngë.

→ B Materiale ndërtimi: gurore, gurë, mermer, rrasa, tjegulla, hekur, bakër, dru, dhe përpunimi i tyre (prerja e druve në pyll, sharrë uji etj).

→ C Kriteret e zgjedhjes: Topografia e përshtatshme për ndërtim, largësia nga për vendbanesën: vendet e punës lidje midis banesave, komunikim pamor, ekzistencë pamje, orientim konkret, ekzistencë uji dhe kullotjeje.

**8.** Nxënësit mund të përgatitin një libër të profesioneve që zhduken me kalimin e kohës. Libri mund të përfshijë:

→ informata për profesionet,

→ material fotografik nga profesionistët,

→ tradita dhe fabula që ekzistojnë rreth tyre,

→ shprehje, krahasime etj që përdoren akoma sot.

**9.** Për shfaqjen në fund të programit çdo nivel paraqet materialin që ka mbledhur për një profesion dhe këndon, kërcen një këngë lidhur më këto. Greqisht dhe Shqip për këngë dhe valle: «Vreshti im fletëgjërë», «Isha unë arkondi i vogel», «Të kisha një postier», «Një ujë zonja Vangjelo», «Një çoban lart në mal». A.8.9. «Ένας βοσκός πάνω στο βουνό».



# Mërgimi

---

Qëllimi kryesor i programit është t'i afrohen nxënësit kuptimit të termave mërgim dhe emigrim, brenda nga elementet që përshkojnë muzikën tradicionale të dy vendeve.

## Synimet:

- të vijnë në kontakt me muzikën tradicionale të dy popujve.
- të dallojnë elementet e përbashkëta që ekzistojnë në këngët e të dy popujve sa në përmbajtje, dhe në shprehjen e tyre muzikore.
- të dëgjoni me kujdes llojet e ndryshme të muzikës dhe të dallojnë elementet bazë.
- të njohin pasurinë e madhe të emocioneve dhe të ideve që fshehin këngët popullore në të dyja krahinat.
- të mësojnë shkaqet e emigrimit të kafshëve dhe zogjve që jetojnë në të dyja zonat.
- të njohin shkaqet e emigrimit të banoreve nga të dyja anët e kufijve.
- të zbulojnë nxënësit se mërgimin e kanë jetuar të dy popujt fakt që mbeten në muzikën e tyre tradicionale.
- të informohen ndjenjat që krijohen edhe në ata që ikin dhe në ata mbeten pas, si dhe në mënyrën që përballojnë vështirësitë që krijon kjo gjendje.
- të bëjnë miq, pavarësisht nga origjina e tyre, por dhe të pranojnë diferencimin si element pasurimi dhe frymëzimi për krijimi të mëtejshëm.
- të kuptojnë termin emigrim dhe mërgim dhe të ndërjegjesohen se mund të bëhemi të gjithë emigrantë.
- të kuptojnë se trazimi i elementeve kulturove të popujve brenda nga valët emigruese është element zhvillimi dhe krijimi dhe, jo rrezik për traditën e një vendi.
- të dallojnë duke parë disa vegla muzikore dhe t'ia vendosin në familjet që u përkasin (aerofonë, kordofonë, idiofonë etj.)



## Pretekst

- E.1.8. «Dimri i mallkuar»
- E.7.5. «Bëra Pashkët vetëm në mërgimin e shretë»
- E.9.4. «Të kisha një postier»
- E.9.8. «Jani im .shamia jote»
- E.9.14. «Nëna ime, lulet e mia»
- E.9.15. «Ikën, ikën, levendi im»
- E.12.7. «Aleksandra»
- E.13.5. «Tani është maj dhe pranverë»
- E.14.13. «Si të them të keni shëndet»
  
- A.1.7. «Të tre vëllezërit Frashëri
- A.5.17. «Lule, moj lule»
- A.4.5. «Iku djali në mërgim»
- A.4.6. «Për ku u nise të shkosh»
- A.8.5.6. «Për ku u nise të arrish»

## 1

1. Nxënësit këndojnë këngë mërgimi. Aktivitetet u përkasin të dyja krahinave, nxënësit nga Greqia mund të mësojnë «Jani im, shamia jote» dhe nxënësit nga Shqipëria «Lule moj lule». Në rast se klasa përbëhet nga nxënësit me kultura të ndryshme me shqipofonë dhe greqofonë mundin të ndihmojnë njëra pal tjetrën për të mësuar të këndojnë kolektivisht të dyja këngët.

2. E.12.5. «Aleksandra», E.7.5. «Bëra Pashkë vetëm në mërgimin e shkretë», E.9.15. «Ikën, ikën levendi im», E.13.5. «Tani është maj dhe pranverë», E.14.13. «Si të them të keni shëndet». Nxënësit ftohen të zbulojnë personat që duken në këngët, cilët ikin, cilët qëndrojnë, si dhe emocionet që ndejnë. Mund të thellohen më shumë në ndojnë këngë, duke bërë më



shumë pyetje. P.sh.: Në këngën E.13.5. «Tani është maj dhe pranverë» mund të bëhen pyetjet e mëposhtme ndodheni midis personave të vjershës:

- Në çilën stinë të vitit jemi?
- Ç' shikoni të ndryshojë në natyrë rreth jush?
- Çfarë gjëra ju rrethojnë?
- Kush ikën?
- Kush mbetet pas?
- Për ç' arsye bën udhëtimin?
- Me se do të udhëtojnë?
- Si e ndjen vetën ai që ikën dhe si ai që mbetet?
- Ç' urime do t'i jepnit të mërguarit dhe çfarë do t'i thoshnit njeriut që mbetet pas?

**3.** Dhe të trija nivelet marrin pjesë në paraqitjen e shfaqjes së fundit të skenarit me këngë mërgimi, me valle, ekzpozita pikturë dhe shumë punime të nxënësve. Aktivitetet me këngë mërgimi, me valle, ekzpozita pikturë dhe shumë punime të nxënësve.

**2**

**1.** Për aktivitetin e parë nga libri i aktiviteteve të nxënësit propozohen këto zona: Epiri, Thraki, Ishuj e Egjent Kikladon–Dodekanisa, Kretë, Dropull, Shkodër, Tepelenë, duke qenë fakt se tradita muzikore në këto zona është veçanërisht e veçantë.

**2.** Nxënësit këndojnë këngë të mërgimit. Në mënyrë që aktivitetet t' u përkasin të dyja krahinave, nxënësit nga Greqia mund ta mësojnë «Jani im, shamia jote» dhe nxënësit nga Shqipëria «Lule, moj lule». Në rast se klasa ka nxënës dhe nga Shqipëria dhe nga Greqia mund të ndihmojnë njëri-tjetrin për të mësuar të këndojnë kolektivisht të dyja këngët.



**3.** E.12.7. «Aleksandra», E.7.5. «Bëra Pashkët vetëm në mërgimin e shkretë», E.9.15. «Ikën, ikën, levendi im», E.14.13. «Si të them të keni shëndet», A.8.5.6. «Për ku u nise të shkosh». Nxënësit ftohen të zbulojnë personat që paraqiten në këngët, cilët ikin, cilët mbeten, si dhe emocionet që ndjejnë. Gjithashtu të thëllohen më shumë në ndonjë këngë, duke bërë më shumë pyetje.

P.sh. Tek kënga A.8.5.6. «Për ku u nise të shkosh» të vihen pyetjet e mëposhtme:

- Cilët bisedojnë tek kënga?
- Cili është vendi i tyre?
- Cili ikën dhe cili mbetet prapa?
- Cili është vendi i mbërritjes?
- Ç' pengesa hasin gjatë lëvizjes?
- Ç' dëshiron çdo njëri?

**4. Shije ndërkuftare.** Kërkoni nga nxënësit të mbledhin receta gjellësh, ëmbelsirash nga atdheu i tyre në të dyja anët e kufirit, duke pyetur më të rriturit. Mund t' regjistrojnë, t'i shtypin dhe pasi zbukurojnë kopërtinën krijojnë librin e tyre të recetave.

**5.** Për vitin 2008 që i është përkushtuar dialogut ndërkulturor mund të orgazinoni ciklin tuaj të shfaqjeve që do të përmbajë:

- Ekspozitë me fotografi me material nga arshiva dhe modern që do të mblidhni me temë emigrimin e të dy popujve.
- Ekspozitë e afishës që do të krijojnë nxënësit për shfaqjen.
- Koncert me muzikë dhe këngë nga të dyja vendet me temë mërgimin.
- Paraqitje punimesh, tablosh dhe paraqitja e gjithë materialit që u grumbullua gjatë gjithë vitit.
- Paraqitja e recetave me temë «Shije ndërkuftare».
- Gjatë shfaqjes mund të ekzistojnë «bufe» me shije nga recetat që u grumbulluan.



3

1. Për aktivitetin e parë mund t'i drejtoni nxënësit sipas lëndës që u zhvillua. gjithashtu, propozohet të vlerësohen si shtete: Anglia, Franca, Gjermania, Shqipëria.

## 2. Shih

Ndani nxënësit në pesë grupe. Çdo grup do të marrë përsipër një familje të veglave muzikore dhe do ta paraqesë në klasë. I nxisni të gjejnë fotografi dhe të bëjnë një kolaz si dhe pjesë muzikore, në të cilat të dëgjohen vegla nga familja e veglave që paraqesin. Mund të vlerësojnë vegla që ndoshta ekzistojnë në shkollë, ose në shtëpitë e tyre. Nëse ndokush prej tyre di të ekzekutojë ndonjë vegël muzikore, është rast të japë një koncert në klasë.

3. Cd me shembuj, nga lloje të muzikës në të cilat gërnetat është vegla bazë. Ideja është të hyjnë hartë, që duke bërë klik nxënësi në zonë të dëgjojnë dhe pjesën përkatëse muzikore. Për traditën muzikore greke do të vlerësohet pjesë nga materiali.

4. Nxënësit ndahen në tri grupe. Kërkoni prej tyre të bëjnë një punim të njëjtë me titull «Violina udhëton...» çdo grup do të marrë përsipër të paraqesë historinë e violinës dhe rrugën e saj në secilin nga të trija llojet e muzikës që ka takuar : në tradicionalen, në klasikën në xhazin.

5. E.12.7. «Aleksandra», E.7.5. «Bëra Pashkët vetëm në mërgimin e shretë», E.9.15. «Ikën, ikën levendi im», E.14.13. «Si të them keni shëndet», A.8.5.6. «Për ku u nise të shkosh». Nxënësit ftohen të zbulojnë personat që duken në këngët cilët ikin, cilët rrinë, si dhe emicionet që ndjejnë. Mund të thëllohen më shumë në ndojnë këngë duke vënë më shumë pyetje.

P.sh. Në këngen A.8.5.6. «Për ku u nise të shkosh» mund të vihen pyetjet e mëposhtme:

- Cilët bashkëbisedojnë në këngën ?
- Cili është vendi i tyre?



- Kush ikën, kush qëndron?
- Cili është vendi i mbërritjes?
- Ç' pengesa hasin gjatë lëvizjes?
- Çfarë dëshiron çdo njëri?

**6.** I vëmë nxënësit të kërkojnë në librat e bibliotekës dhe të gjëjnë pjesë që flasin për të mërguarit. Këto pjesë do të lexohen nga grupet dhe do të paraqesin në klasë qëndrimin e shrimtarit, pikpamjet e tij dhe mesazhin që jep. Si shembull përmend librat e mëposhtëm:

- Akrivos, Kostas, 1985, «E huaja», Athinë, Nea Sinora Livani.
- Aleksandru, Dafni, 1994, «Linda në Aleksandria, në adio Aleksandria», Athinë, Aleksandria.
- Venezis, Ilias, 1969, «Toka Eolike», Athinë, Estia
- Dumbadze, Nodar, 1992, «Hellados: një grek i vogël i kaukazit», Athinë, shoqata kulturore Panorama.
- Petroviç-Andrukopulu, Loti, 1989, «Gabim, zoti Noiger!», Athinë, Patakis.
- Hristovasilis, Hristos, 1996, «Tregime të mëgimit», Selanik, Zitros.

**7. A.4.6. «Për ku u nise të shkosh».** Njerëzit që ndërruan vendbanimin morën me vete një valixhe të mbushur me ëndërra. Bagazhet e tyre nuk kishon vetëm rroba dhe diçka që u duhej. Merrnin me vete dhe elemente të tjera të kulturës së tyre. I ftoni nxënësit të zbulojnë ndikimet e mundshme, që pranoi zona e tyre (zakonet e të ushqyerit, këngë, dhe elemente të tjera të kulturës). Kërkokoni nga nxënësit të mbedhin receta gjellësh, ëmbëlsirash nga vendet e tyre nga të dyja anët e kufirit, duke pyetur më të rriturit. Mund t'i regjistrojnë, t'i shtypin dhe pasi të rregullojnë kopertinën, krijojnë librin e tyre të recetave.

**8. Shije ndërkuftare:** Kërkon nga nxënësit të mbledhin receta gjellësh, ëmbëlsirash nga atdheu i tyre në të dyja anët e kufirit, duke pyetur më të rriturit. Mund t' regjistrojnë, t'i shtypin dhe pasi zbukurojnë kopertinën krijojnë librin e tyre të recetave.



**9. 2008: Vit evropian i dialogut ndërkulturor** ([www.dialogue2008.eu](http://www.dialogue2008.eu))

(Burim: <http://filosofia.gr/blogs/index.php?op=ViewArticle&articleId=855&blogId=20>)  
Komisioni Evropian ka ndërtuar në bashkëpunim me organizata të shoqërisë së qytetarëve një vend interneti ([www.dialogue2008.eu](http://www.dialogue2008.eu)), i cili ka qëllim të shtyjë përpara krijimin e një vendi të përbashkët evropian për dialogun ndërkulturor, të mbulojë tema, si mjetet e informacionit, artet dhe trashëgiminë, vendi e punës, dialogun midis feve, arsimin dhe emigrimin dhe inkuadrimin. Mund të vizitoni në klasë këtë vend interneti dhe nxënësit të shprehin mendimet e tyre dhe problematikizimin.

**10.** Në kuadrin e mësimëve dhe të kontaktit të fëmijëve me artin kinematografik mund të paraqiten filma ose fragmente filmi me temë emigrimin. Filmat me temë emigrimi janë te shumta dhe mijëra janë këngët dhe muzikat e botës me të njëjtën temë. Të gjithë me qëllim të vetëm të shprehin emocionet, dhimbjet dhe mendimet e tyre.

Festivali i kinemasë në Selanik bëri një dedikim i cili shënoi sukses të madh, me temë: «Emigrimi në kinemanë greke (1956-2006)».

Dedikimi udhëton jashtë shtetit me symin të paraqitet dedikimi në institucione universitare dhe në entet kulturore jashtë shtetit, dhe t'i afrohet publikut atje që interesohet për kinemanë greke, historinë, kulturën greke por e dhe publikun që meret me çeshjen kritiken të mërgimit dhe të ripërfytyrimeve të saj. Dedikimi ka vizituar Oksfordin, Cikagon, Nju Heiven, (Universiteti Jeil) dhe Torondon dhe programatizohet të pritet brenda vitit 2008, Sidnei të Australisë, ashtu dhe në qytete të mëdha evropiane. Filma që shfaqen janë:

- Dollarë dhe ëndërra – Ioanna Daifa
- Letra nga Amerika – Lakis Papastathis
- Fografia – Nikos Papatakis
- Omeri – Kostantinos Jannaris
- Nga dëbora – Sotiris Goricas
- Mirupafshim – Jorgo Kora, Hristo Vupura
- Një grua qërron mollë brenda shtëpisë – Ektoras Ligizos
- Delivery – Nikos Panajotopoulos
- Mermeret – Aleksis bistikas



- Emigranti – Nestoras Macias
- Omeri – K.Jannaris
- Deri tek anija – A. Damianos
- Nuset – P.Vulgaris

(<http://agenda.pathfinder.gr>)

### **NGA DEBORA (Gjatësisë së madhe te Sotirit Gorica, 1993)**

«Erdhi Thomas në fshat dhe më tha për katër të vdekurit. I Thanasit Koci, thotë, i kishte marrë e shtëna gjithë pjesën e pasme të kokës. Thomas edhe unë e kemi vendosur. Sonte ikim për në Greqi. Ku shkojmë?». «Tek atdheu», them unë. «Në zhdukje», thotë Thomas dhe qesh. Këshu fillon zbritja mëkatore e tre vorioipirotëve të arratisur, «nga bora» deri në thellësi të Omonias. Atje, do të gjenden përballë me urinë, me zhdukjen e ëndërrimit, simptomat e para të një racizmi të papërshtetshëm të banorëve modernë të Athinës. Kur Thomas do të gjejë një vdekje të parakohshme në një skelë tjetër «vrasëse» të një shumëkatëshi, tregimtari do të vendosë të kthehet tek bora, atje ku të paktën ëndërrat ruhen. Shikimi i ndershëm «i ftohte» pothuajë dokumentar i regjizorit mbi këtë problem të mprehtë shoqëror nuk shmang mallëngjimin e shikuesit, kjo përbën ndoshta suksesin kryesor të filmit. Një kinema e ashprë që shmang vështirësitë e mëdha të natyralizimit që po zhvillohet, dhe një afrim njerëzor, që nuk ndihmon me predikime çjerrse shpjegimet e ashpra të dy protagonistëve shtojnë akoma dhe një avantazh në rezultatet e fundit.

### **NUSET (I gjatësisë së madhe të Pandeli Vulgarit, 1922)**

Fotografi Norman Haris dhe Niki udhëtojnë në të njëjtën anije për në Amerikë. Norman në vendin e parë dhe Niki në vendin e tretë bashkë me 700 nuse të tjera. Të gjitha kanë me vete fotografinë e një dhëndri të panjohur dhe fustanin e nusërisë së tyre në valixhën e tyre. Norman emocionohet duke parë nuset që rrinë në vendin e tretë, Niki është ajo që e mahnit më shumë. Pak nga pak njihen dhe dashurohen. Supëroqeaniku «King Aleksandër» mbërrin në portin e Nju Jorkut. Në kuvertën e anijes shkruhet epilogu i lidhjes Niki-Norman. «Nuset» janë një histori për emocionet e forta, për dilemat, për ndërgjegjen për qëndrimin përgjegjes. Për çastet të vogla, për shikimet përprekjet për «po» dhe «jo» që kanë rëndësi në jetë. (<http://www.g.f.c./gr/movies/index.asp>)




**11.** Për vitin 2008 që i kushtohet dialogut ndërkulturor mund të organizoni ciklin tuaj të shfaqjeve që do të përmbajë:

- Ekzpozitë fotografike me material arshivor dhe modern që do të grumbulloni.
- Ekzpozitë me afisha që do të krijojnë për shfaqjen, koncert me muzikë dhe këngë për mërgimin.
- Paraqitje e punimeve, vizatimeve dhe gjithë materialit që u mbledh gjatë vitit.
- Paraqitje e recetave me temë «shije ndërkufitare».
- Gjatë shfaqjes mund të ekzistojë «bufe» me shije nga recetat që u mbledhën.



Material edukativ është krijuar në kuadrin e programit  
Bashkëpunim kërkues dhe edukimi nga largësia në kulturën greke



Vepra u realizua ne kuadrin e Programit INTERREG III / PROGRAMI I FQINJESISE GREQI- SHQIPERI  
Boshti 2-Metri 2.2. me bashkefinancim nga Fondi Evropian i Zhvillimit Periferik (F.E.ZH.P.) dhe nga Burime Kombetare.  
Pergjegjes Shkencor: Anastasios Emvalotis, Profesor Asistent i Universitetit te Janines